

# Mekanizmi i Pavarur I Raportimit (MPR): Raporti Përfundimtar për Shqipërinë 2018 -2020

---

Stafi i MPR-së në bashkëpunim me Elvana Gadeshi, hulumtuese e pavarur

## Përmbajtja

<b>Përmbledhja Ekzekutive: Shqipëria</b>	<b>2</b>
<b>I. Hyrje</b>	<b>5</b>
<b>II. Konteksti i Qeverisë së Hapur në Shqipëri</b>	<b>6</b>
<b>III. Procesi i Lidershipit dhe grupit shumë-aktorësh</b>	<b>10</b>
<b>IV. Angazhimet</b>	<b>14</b>
1. Qeverisje e Hapur për të Rritur Transparencën në Raportimin Qeveritar dhe për të Përmirësuar Aksesin në Informacion	16
2. Qeverisja e Hapur për të Modernizuar Shërbimet Publike dhe E-Gov	20
3. Qeverisje e Hapur për “Better Regulation”	22
4. Qeverisje e Hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta	25
<b>V. Rekomandime të Përgjithshme</b>	<b>28</b>
<b>VI. Metodologjia dhe Burimet</b>	<b>33</b>
<b>Shtojca I. Pasqyra e performancës së Shqipërisë gjatë zhvillimit të planit të veprimit</b>	<b>36</b>



## Përmbledhje Ekzekutive: Shqipëria

Angazhimet e planit të katërt të veprimit për Shqipërinë adresojnë reformat e administratës publike që janë të rëndësishme për procesin në vazhdim të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian (BE). Aktivitete të rëndësishme përfshijnë krijimin e një portali të dhënash të hapura (Angazhimi 2) dhe inkurajimin e qytetarëve për të përdorur platforma online për raportimin e korrupsionit (Angazhimi 4). Shoqëria civile kryesisht mungonte gjatë zhvillimit të angazhimeve dhe kontributi i saj në planin e veprimit përfundimtar ishte i kufizuar. Për planin e ardhshëm të veprimit, Shqipëria duhet t'i përmbahet standardeve të Pjesëmarrjes dhe Bashkëkrijimit të PQH-së, dhe të krijojë një forum të dedikuar shumë-aktorësh për PQH-në. Shqipëria gjithashtu mund të konsiderojë në planin e ardhshëm të veprimit përfshirjen e angazhimeve të cilat lidhen me përmirësimin transparencës në prokurimin publik dhe gjyqësorit.

Partneriteti për Qeverinë e Hapur (PQH) është një partneritet global që bashkon reformatorët e qeverisë dhe drejtuesit e shoqërisë civile për të krijuar plane veprimi që i bëjnë qeveritë më gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme e llogaridhënëse. Mekanizmi i Pavarur i Raportimit (MPR) monitoron të gjitha planet e veprimit për të siguruar që qeveritë të zbatojnë angazhimet. Shqipëria iu bashkua PQH-së në vitin 2011. Që nga ajo kohë, ka zbatuar tre plane veprimi. Ky raport vlerëson procesin e hartimit të planit të katërt të veprimit të Shqipërisë.

### Pasqyrë e përgjithshme e planit të veprimit

Angazhimet në planin e katërt të veprimit në Shqipëri adresojnë disa reforma të administratës publike që janë të rëndësishme për procesin e integritetit të vendit në BE. Disa fusha të politikës së qeverisë së hapur që janë të rëndësishme për Shqipërinë, por që nuk përfshihen në planin e veprimit, janë reforma në gjyqësor dhe adresimi i mangësive në legjislacionin mbi qasjen ndaj informacionit.

Hartimi i planit të katërt të veprimit u drejtua nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes pranë zyrës së Kryeministrit. Në përgjithësi, shoqërisë civile në Shqipëri nuk iu dha mundësia të propozonte angazhime ose të jepte përparësi fushave të caktuara të politikave.

Mungesa e një forumi të dedikuar shumë-aktorësh, kufizoi ndjeshëm mundësitë për shoqërinë civile për t'u përfshirë në procesin e PQH-së dhe çoi në mungesë të interesit të shoqërisë civile ndaj planit të katërt të veprimit.

Katër angazhimet në planin e veprimit rrjedhin nga dokumentet ekzistuese strategjike mbi mirëqeverisjen dhe reformën e administratës publike. Angazhimet kryesisht synojnë të përmirësojnë transparencën e financave publike, aksesin në shërbimet publike dhe rregullat e

### Tabela 1. Një shikim i shpejtë

Pjesëmarrës që nga viti: 2011  
Plani i veprimit në shqyrtim: i katërti  
Lloji i raportit: Hartimi  
Numri i angazhimeve: 4

### Zhvillimi i planit të veprimit

A ekziston një forum shumë-aktorësh: Jo  
Niveli i ndikimit publik: Konsultë  
Ka vepruar në kundërshtim me procesin PQH: Po

Hartimi i planit të veprimit  
Angazhimet e rëndësishme për vlerat e PQH-së: 4 (100%)  
Angazhimet transformuese: 0  
Potencialisht me yje: 0

Zbatimi i planit të veprimit  
Angazhimet me yll: 1 pa aplikueshëm  
Angazhimet e përfunduara: 1 pa aplikueshëm  
Angazhimet kryesisht me AMQH\*: 1 pa aplikueshëm  
Angazhimet të dallueshme me AMQH\*: 1 pa aplikueshëm

\*AMQH: A Mundësoi Qeveri të Hapur?



Versioni për koment publik: Ju lutemi mos citoni

administratës publike. Veçanërisht, Angazhimi 4 synon të forcojë organet kundër korrupsionit në Shqipëri, të krijojë një sistem on-line të deklaratave të pasurive për zyrtarët publikë dhe të nxisë qytetarët të përdorin platforma online për raportimin e korrupsionit.

**Tabela 2. Angazhime të rëndësishme**

<b>Përshkrimi i Angazhimit</b>	<b>Përmirësimet</b>	<b>Statusi në fund të ciklit të zbatimit</b>
<b>2. Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe elektronike</b>	Ky angazhim synon të përmirësojë qasjen në shërbimet e-Gov në portalin e-Albania dhe të krijojë një portal të ri kombëtar me të dhëna të hapura. Në hapat e mëtejshme, qeveria mund të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të mekanizmave të dhënies së opinioneve (feedback) dhe të zhvillojë dhe gjermojë indikatorët e performancës për këtë angazhim	<i>Shënim: kjo do të vlerësohet në fund të ciklit të planit të veprimit</i>
<b>4. Qeverisje e hapur për të krijuar komunitete të sigurt</b>	Ky angazhim përfshin një shumëllojshmëri aktivitetesh për të forcuar mekanizmat dhe institucionet e parandalimit të korrupsionit në Shqipëri. Në hapat e mëtejshëm, rastet e korrupsionit mund të ndiqen më mirë dhe të dhëna përkatëse mund të vihen në dispozicion të publikut.	<i>Shënim: kjo do të vlerësohet në fund të ciklit të planit të veprimit</i>

## Rekomandime

Rekomandimet e MRP-së kanë për qëllim të informojnë mbi zhvillimin e planit të ardhshëm të veprimit dhe udhëzimin për zbatimin e planit aktual të veprimit.

Tabela 3. Pesë Rekomandimet KYÇE të MPR-së

1	Respektimi i Standardeve të Pjesëmarrjes dhe Bashkëkrijimit të PQH-së
2	Krijimi i një forumi të dedikuar shumë-aktorësh me kritere të qarta dhe transparente zgjedhjeje për anëtarët e tij.
3	Sigurimi i zbatimit efektiv të legjislacionit të konsultimit publik
4	Konsiderimi i përfshirjes së angazhimeve të cilat lidhen me kontraktimin e hapur dhe prokurimin publik
5	Konsiderimi i përmirësimit të transparencës dhe integritetit të gjyqësorit

**Elvana Gadeshi** është një eksperte me eksperiencë të gjatë profesionale në çështje që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e performancës.

**Partneriteti i Qeverisë së Hapur (PQH)** synon të sigurojë angazhime konkrete nga qeveritë për të promovuar transparencën, fuqizuar qytetarët, luftuar korrupsionin dhe të përdorë teknologjitë e reja për të forcuar qeverisjen Mekanizmi i Pavarur i Raportimit (MPR) vlerëson zhvillimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për të nxitur dialogun midis palëve të interesuara dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë.

Open  
Government  
Partnership



## I. Hyrje

Partneriteti i Qeverisë së Hapur është një partneritet global që bashkon reformatorët e qeverisë dhe drejtuesit e shoqërisë civile për të krijuar plane veprimi që i bëjnë qeveritë më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme. Angazhimet e planit të veprimit mund të bazohen në përpjekjet ekzistuese, të identifikojnë hapa të rinj për të përfunduar reformat në vazhdim, ose të fillojnë veprime në një zonë krejtësisht të re. Mekanizmi i Pavarur i Raportimit i PHQ-së (MPR) monitoron të gjitha planet e veprimit për të siguruar që qeveritë të zbatojnë angazhimet. Shoqëria civile dhe udhëheqësit e qeverisë përdorin vlerësimet për të reflektuar në progresin e tyre dhe për të përcaktuar nëse veprimet kanë ndikuar në jetën e njerëzve.

Shqipëria u anëtarësua në PQH në vitin 2011. Ky raport përfshin zhvillimin dhe hartimin e planit të katërt të veprimit të Shqipërisë për periudhën 2018-2020.

Mekanizmi i Pavarur i Raportimit i PQH-së ka bashkëpunuar me Elvana Gadeshin, e cila ka kryer këtë vlerësim. MPR-ja synon të informojë dialogun në vazhdim rreth zhvillimit dhe zbatimit të angazhimeve të ardhshme. Për një përshkrim të plotë të metodologjisë së MPR-së, ju lutemi vizitoni <https://www.opengovpartnership.org/about/independent-reporting-mechanism>

## II. Konteksti i Qeverisjes së Hapur në Shqipëri

Shqipëria vazhdon të zbatojë reformat nën PQH, që janë të rëndësishme për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Angazhimet në planin e katërt të veprimit janë përqendruar kryesisht në reformën e administratës publike, shërbimet elektronike, teknologjinë dhe inovacionin. Sidoqoftë, plani i veprimit nuk ka kapur çështje kritike siç janë kontraktimi i hapur dhe reforma në gjyqësor.

### 2.1 Historiku

Shqipëria ka bërë përmirësime të dukshme për mirëqeverisjen gjatë njëzet viteve të fundit, por vendi vazhdon të përballet me sfida përsa i përket institucioneve të qëndrueshme demokratike, sundimit të ligjit dhe masave efektive kundër korrupsionit. Që nga anëtarësimi në PQH në vitin 2011, Shqipëria ka zbatuar tre plane veprimi dhe ka respektuar në mënyrë të vazhdueshme me kriteret e pranueshmërisë së PQH-së që përfshijnë aksesin në informacion, transparencën e buxhetit, deklarimin e pasurive dhe angazhimin e qytetarëve.

### Aksesi në informacion

Ndërsa e drejta për të hyrë në informacionin publik në Shqipëri rregullohet me Ligjin për të Drejtën e Informimit, zbatimi i këtij ligji ka zbuluar mangësi në kuadrin ligjor. Si pjesë e planit të tretë të veprimit të Shqipërisë (2016-2018)<sup>1</sup> më shumë autoritete publike kanë miratuar programe transparence, por nevojiten më shumë përpjekje për të promovuar zbulimin proaktiv të informacionit nga institucionet publike<sup>2</sup>. Në Indeks Global të të Dhënave të Hapura 2016<sup>3</sup>, Shqipëria renditet e 47-ta, mbi disa vende në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Sipas Raportit të Progresit të MPR-së për planin e tretë të veprimit të Shqipërisë, megjithë përmirësimet modeste në portalin e të dhënave të hapura të Bashkisë së Tiranës, të dhënat e hapura në Shqipëri mbeten pak të zhvilluara<sup>4</sup>. Gjithashtu, sipas Raporteve pa Kufij, autoritetet shtetërore ndonjëherë u mohojnë gazetarëve mundësinë e përdorimit të dokumenteve që kanë interes të ligjshëm e thelbësor publik, veçanërisht ato që lidhen me kontratat publike, ofertat dhe koncesionet<sup>5</sup>.

### Transparenca e buxhetit

Sipas Vëzhgimit të Buxhetit të Hapur të vitit 2017 të Partneritetit Ndërkombëtar të Buxhetit, qeveria e Shqipërisë publikon shtatë nga tetë dokumentet kryesore të buxhetit në një afat kohor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislatura dhe institucioni suprem i kontrollit sigurojnë një mbikëqyrje të duhur të buxhetit<sup>6</sup>. Buxheti i vitit 2018, buxheti i qytetarëve<sup>7</sup> për projektbuxhetin e vitit 2018 dhe lista e investimeve publike në kuadër të programit buxhetor afatmesëm janë publikuar, por mundësitë për pjesëmarrje të publikut në procesin e buxhetit mbeten të kufizuara. Shqipëria renditet gjithashtu në vendin e 42-të nga 140 vendet në fushën e transparencës së buxhetit në Raportin Global të Konkurrencës së Forumit Ekonomik Botëror 2018<sup>8</sup>.

### Angazhimi qytetar

Shoqëria civile në Shqipëri është - në parim - e lirë të marrë pjesë në të gjitha hapat e hartimit dhe zbatimit të politikave. Kuadri ligjor dhe institucional ka bërë përparime përsa i përket përfshirjes së shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes politike. Megjithatë, sipas Indeksit të Transformimit Bertelsmann 2018 (BTI), kapacitetet e dobëta institucionale, ndarja e pozicioneve të personelit midis politikës dhe OJQ-ve dhe tërheqja e fondeve të donatorëve kanë kufizuar angazhimin e shoqërisë në politikëbërje<sup>9</sup>.

Qeveria ka ndërtuar në mënyrë aktive një mjedis të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile duke ngritur Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile në Nëntor 2015<sup>10</sup>. Përfaqësuesve të shoqërisë civile u jepen gjithashtu vende në Këshillin Kombëtar për Integrimin në BE, një forum i krijuar për të përfshirë shoqërinë civile në procesin e integritimit të Shqipërisë në BE<sup>11</sup>. Shqipëria ka hartuar gjithashtu një plan pune për periudhën 2019-2023 me qëllim përmirësimin e marrëdhënieve të qeverisë me shoqërinë civile<sup>12</sup>.

Sipas Indeksit të Qëndrueshmërisë së OShC-ve për vitin 2018 për Shqipërinë, qëndrueshmëria financiare vazhdon të jetë një dobësi e madhe për OShC-të shqiptare, me shumicën dërrmuese të OShC-ve të varura nga fondet e huaja. Ndërsa shoqërisë civile i mungon aksesin në burime të shumta

të financimit, Agjencia për Mbështetje të Shoqërisë Civile (AMSHC) mbetet burimi kryesor i financimit të brendshëm për OSHC-të. Grantet publike jepen përgjithësisht në një mënyrë zyrtare transparente, përfshirë përdorimin e thirrjeve publike me kritere të përcaktuara qartë të përzgjedhjes. Megjithatë, nuk është publikuar asnjë informacion mbi ankesat në lidhje me konkurrencën e proceseve të përzgjedhjes<sup>13</sup>.

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2019 për Shqipërinë, Ligji për Konsultimin Publik i vitit 2014 është përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane mbi normat procedurale për transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Ligji për konsultimin publik kërkon që qeveria të raportojë se si janë trajtuar propozimet nga shoqëria civile gjatë hartimit të legjislacionit. Megjithatë, ka pak prova mbi përdorimin dhe efikasitetin e mekanizmit të opinionëve<sup>14</sup>. Sipas një sondazhi të vitit 2018, drejtuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, vetëm 45% e OSHC-ve të anketuara në Shqipëri ranë dakord që procedurat e këshillimit zyrtar u përputhën me parakushtet për përfshirje efektive në hartimin e politikave dhe vetëm 19 % ranë dakord që institucionet qeveritare përdorin në mënyrë të vazhdueshme procedurat e këshillimit gjatë hartimit të politikave brenda fushës së tyre të veprimit. Vetëm 12% e OSHC-ve të anketuara deklaruan që ministrinë përkatëse u dhanë përgjigje me shkrim konsulentëve nëse opinioni i tyre ishte përfshirë dhe vetëm 10% deklaruan që ministrinë përkatëse i pranuan opinionet që u bënë nga organizatat e tyre.<sup>15</sup>

### **Liria e shprehjes dhe media**

Kushtetuta shqiptare siguron një gamë të gjerë të lirive të mbledhjes, shprehjes dhe bashkimit në shoqata. OSHC-të mund të regjistrohen, të menaxhojnë punët e tyre dhe të adresojnë të gjitha çështjet e debatit publik pa ndërhyrje ose kufizime të shtetit. Sidoqoftë, procesi i regjistrimit të OSHC-ve mbetet me kosto të lartë dhe kërkon kohë, me procedura të gjata dhe mungesë të gjyqtarëve të specializuar në sektorin e shoqërisë civile. Individët janë të lirë të formojnë apo të bashkohen me parti të pavarura politike, të cilat gjithashtu veprojnë dhe bashkohen pa ndërhyrjen e shtetit. Shqipëria ka një gamë të gjerë mediash të pavarura, e cila ka përmirësuar mbulimin e proceseve politike, politikave qeveritare dhe veprimeve të gabuara<sup>16</sup>. Rrjeti Ballkanik i Raportimit Hetimor (BIRN), një burim hetimor për gjithë rajonin ka siguruar informacion të pavarur për disa raste të korrupsionit politik të nivelit të lartë. Fix Fare dhe STOP, dy programe investigative satirike nga Top Channel dhe Klan, gjithashtu kanë tërhequr vëmendjen për raste korrupsioni. Megjithatë, fakti që shumica e mediave financohen nga pronarë me interes në biznese të tjera e ndërlikon cilësinë e përgjithshme dhe pavarësinë e raportimit të medias në Shqipëri<sup>17</sup>.

### **Antikorrupsioni**

Shqipëria ka përmirësuar kuadrin ligjor për luftën kundër korrupsionit duke miratuar ndryshime në kodin e procedurës penale<sup>18</sup>. Është krijuar një zinxhir organesh të specializuara kundër korrupsionit, duke përfshirë një zyrë të veçantë në prokurori.

Sipas Komisionit Evropian, numri i dënimeve që përfshijnë zyrtarë të rangut të ulët ose të mesëm është rritur në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese.<sup>19</sup>

Komisioni Evropian gjithashtu ka raportuar që dënimet e zyrtarëve të lartë kanë ndodhur në shumicën e rasteve në drejtësi (gjykatës dhe prokurorë), ndërsa shkalla e dënimeve përfundimtare për zyrtarët e rangut të lartë mbetet e ulët. Në vitin 2016, Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit paraqiti një sistem monitorimi për rastet e korrupsionit. Megjithatë, është arritur pak progres në krijimin e një mënyre ndërveprimi midis sistemeve të ndryshme elektronike të menaxhimit të çështjeve të policisë, prokurorisë dhe gjykatave, pjesërisht nga mungesa e një buxheti të mjaftueshëm<sup>20</sup>.

Roli i Inspektoriatit të Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktëve të Interesit (ILDKPKI), në zbulimin e konfliktëve të interesit dhe kontrollin e deklarave të pasurive, u forcua me miratimin e Ligjit për mbrojtjen e informimit dhe informatorit në vitin 2016. Për më tepër, Ligji për Deklaratat e Pasurive, i ndryshuar, zgjeron rrethin e zyrtarëve publikë të detyruar të deklarojnë pasuri, duke mbuluar anëtarët e gjyqësorit, këshillin e lartë të prokurorisë dhe menaxherëve të kompanive publike të kufizuara. Sidoqoftë, Shqipëria nuk ka ende një sistem të deklarimit të pasurive online.

### **Qëllimi i planit të veprimit**

Plani i katërt i veprimit përfshin angazhimet për të dhëna të hapura, reformën e administratës publike, akses në informacion dhe nismat kundër korrupsionit. Angazhimet u hartuan përmes një kornize specifike metodologjike dhe adresojnë dy nga pesë prioritetet e pranimit në BE të Shqipërisë<sup>21</sup>. Megjithatë, plani i veprimit nuk adreson prioritetet e tjera të rëndësishme për integrimin në BE, siç është reforma në sektorin e drejtësisë. Reforma në drejtësi mund të çojë në përmirësime të konsiderueshme në fushat e qeverisjes së hapur, llogaridhënies dhe sundimit të ligjit. Përveç kësaj, që nga viti 2017, Shqipëria i është nënshtruar një reforme të madhe në drejtësi, duke përfshirë vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve për aftësi profesionale, verifikim të pasurive dhe lidhje me rrjetet e organizuara kriminale. Deri tani, vetingu ka sjellë rezultate të konsiderueshme dhe ka çuar në shkarkim ose dorëheqje të shumë gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>22</sup>.

Për më tepër, mund të ndërmerren hapa për të siguruar që reformat në drejtësi janë kryer në mënyrë transparente dhe mund të merret në konsideratë përfshirja e tyre në planet e ardhshme të veprimit të PQH-së për Shqipërinë.

---

<sup>1</sup> "Partneriteti i Qeverisë së Hapur Plani i Tretë Kombëtar i Veprimit për Shqipërinë 2016–2018", Partneriteti i Qeverisë së Hapur, 28 Shtator 2016, [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2017/04/Albania\\_NAP3\\_ENG.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2017/04/Albania_NAP3_ENG.pdf)

<sup>2</sup> "Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2018", Komisioni Evropian, 17 Prill 2018, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

<sup>3</sup> "Shqipëria", Indeksi Global i të Dhënave të Hapura, Fondacioni i njohurive të hapura, <https://index.okfn.org/place/al/>

<sup>4</sup> Gjergji Vurmo, "Mekanizmi i pavarur i raportimit (MPR): Raporti i Progresit të Shqipërisë", MPR, Partneriteti i Qeverisë së Hapur, 2018, [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2018/10/Albania\\_Mid-Term\\_Report\\_2016-2018\\_EN.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2018/10/Albania_Mid-Term_Report_2016-2018_EN.pdf)

<sup>5</sup> "Shqipëria: Gjetjet paraprake të misionit të përbashkët për lirinë e shprehjes", Reporterët pa Kufij, 21 Qershor 2019, <https://rsf.org/en/news/albania-preliminary-findings-joint-freedom-expression-mission>

<sup>6</sup> "Vëzhgimi i Buxhetit të Hapur 2017: Shqipëria", Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit, <https://www.internationalbudget.org/wp-content/uploads/albania-open-budget-survey-2017-summary.pdf>

<sup>7</sup> Buxhetet e qytetarëve paraqesin informacione kyçe për financat publike tek një audiencë e përgjithshme. Ato shkruhen zakonisht në gjuhë të kuptueshme dhe përfshijnë elemente vizuale për të ndihmuar lexuesit jo-specialistë të kuptojnë informacionin. Për më shumë informacion shikoni: "Buxhetet e Qytetarëve", Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit, <https://www.internationalbudget.org/open-budget-survey/resources-for-governments/citizens-budgets/>

<sup>8</sup> Klaus Schwab, Forumi Ekonomik Botëror, Raporti Global i Konkurrencës 2018, fq 57, <http://www3.weforum.org/docs/GCR2018/05FullReport/TheGlobalCompetitivenessReport2018.pdf>.

<sup>9</sup> "BTI 2018: Reporti për Shqipërinë", Indeksi i Transformimit BTI, <https://www.bti-project.org/en/reports/country-reports/detail/itc/ALB/#management>

<sup>10</sup> Misioni kryesor i këtij Këshilli është të sigurojë bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile në favour dhe në funksion të zgjerimit të demokracisë.

<sup>11</sup> [I njëjti burim informacioni](#)

<sup>12</sup> Shih: Plani për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023, në dispozicion në [http://www.amshc.gov.al/web/doc/Udherrefyesi-2019-rishikuar-\[EN\].pdf](http://www.amshc.gov.al/web/doc/Udherrefyesi-2019-rishikuar-[EN].pdf)

<sup>13</sup> Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-së për vitin 2018, për Shqipërinë, Europa Qendrore dhe Lindore dhe Eurasia", Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, Byroja për Demokraci, Konflikt dhe Ndhimë Humanitare, Qendra e Ekselencës për Demokracinë, të Drejtat e Njeriut dhe Qeverisjen, Shtator 2019, Fq. 14, <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/resource-csosi-2018-report-europe-eurasia.pdf>

<sup>14</sup> "Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit: Raporti për Shqipërisë 2019", Komisioni Evropian, 25 Shtator 2019, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

<sup>15</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Monitorimi i Reformës Administrative Publike Kombëtare në Shqipëri 2017/2018, Fq. 5 i disponueshëm këtu: <https://idmalbania.org/national-par-monitor-albania-2017-2018/>

<sup>16</sup> [I njëjti burim informacioni](#)

<sup>17</sup> [I njëjti burim informacioni](#)

<sup>18</sup> Kodi i of Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë është përmirësuar me ligjin 35/2017.

<sup>19</sup> Pg. 6. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

<sup>20</sup> <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

<sup>21</sup> Në mënyrë që të fillojnë bisedimet e pranimit në BE, Shqipëria duhet të adresojë pesë përparësi kryesore: anti-korrupsionin, luftën kundër kimit të organizuar, reformën në administratën publike, reformën në drejtësi dhe të drejtat e njeriut.

<sup>22</sup> Pg 14. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>



### III. Procesi i Lidershit dhe grupit shumë-aktorësh

Angazhimet përfundimtare në planin e katërt të veprimit për Shqipërinë janë marrë nga dokumenti strategjik ekzistues, i cili, sipas qeverisë, u zhvillua në konsultim me shoqërinë civile dhe publikun. Sidoqoftë, dokumentacioni i dhënë MPR-së nga qeveria nuk tregon që ka pasur mundësi të dedikuara për palët e interesuara për të hartuar planin e veprimit ose të propozojnë angazhime. Ndërsa disa organizata të shoqërisë civile ishin të ftuar të kontribuojnë në përmirësimin e angazhimit 4, nuk ka asnjë dokumentacion në dispozicion të publikut për propozimet ose komentet që ata mund të kenë bërë.

#### 3.1 Lidershipi

Nën-seksionet përshkruajnë liderшипin e PQH-së dhe kontekstin institucional për PQH-në në Shqipëri.

Në janar 2018, lidershipi i PQH-së në Shqipëri ishte i ndarë midis Ministrisë së Shtetit për Rinovim dhe Administratën Publike (MSHRAP) dhe Zyrës së Kryeministrit<sup>1</sup>. Pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2017, u formua një kabinet i ri (shtator 2017) i cilshkriu MSHRAP-në, duke e lënë PQH-në pa autoritet koordinues deri në fund të vitit 2017. Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes (DZHM) në Zyrën e Kryeministrit është tani zyra kryesore përgjegjëse për aktivitetet e PQH-së në Shqipëri. Kontakti i lartë ministror për PQH-në është Zëvendëskryeministri<sup>2</sup>.

Tre zyrtarë nga stafi i DZHM janë përfshirë në PQH, përfshirë koordinimin dhe zbatimin e planit të veprimit, midis përgjegjësive të tjera që nuk lidhen me PQH-në. Personi e kontaktit për PQH-në në DZHM, koordinon procesin për hartimin e planit të katërt të veprimit, gjurmon ecurinë e angazhimeve përmes personave të kontaktit të PQH-së dhe raporton tek Zëvendëskryeministri për statusin e angazhimeve.

DZHM është gjithashtu Sekretariati Teknik për Grupin e Menaxhimit të Politikave të Integruara për Mirëqeverisje dhe Administratë Publike (GMPI për MAP). Themeluar në vitin 2018, GMPI për MAP ofron një hapësirë për dialog, koordinim, zbatim dhe monitorim të politikave të mirëqeverisjes<sup>3</sup>. GMPI për MAP ka përfaqësues nga ministrinë dhe agjencitë, shoqëria civile (në mënyrë të pavarur dhe përmes Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile) dhe agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit.

Zëvendëskryeministri, si Kryetar i GMPI për MAP, ishte i përfshirë në zhvillimin e planit të katërt të veprimit.

#### 3.2 Procesi shumë-aktorëshgjatë hartimit të planit të veprimit

Në vitin 2017, PQH miratoi Standardet e Pjesëmarrjes dhe Bashkëkrijimit të PQH-së, me qëllim për të mbështetur pjesëmarrjen dhe bashkëkrijimin e shoqërisë civile në të gjitha fazat e ciklit PQH-së. Të gjitha vendet pjesëmarrëse në PQH pritet t'i plotësojnë këto standarde. Standardet synojnë të rrisin ambicien dhe cilësinë e pjesëmarrjes gjatë hartimit, zbatimit dhe rishikimit të planeve të veprimit të PQH-së

Nenet e qeverisjes së PQH-së gjithashtu përcaktojnë kërkesa për pjesëmarrjen dhe bashkëkrijimin, që një vend ose subjekt duhet të përmbushë në hartimin dhe zbatimin e planit të tyre të veprimit, që të jenë në përputhje me procesin e PQH-së. Shqipëria **veproi në kundërshtim** me procesin e PQH-së për arsye si më poshtë<sup>4</sup>:

1. Nuk ka provë demonstruese që ekzistonte një hapësirë apo grup shumë-aktorësh për të diskutuar procesin e PQH-së gjatë zhvillimit të planit të veprimit. GMPI për MAP nuk është një forum shumë-aktorësh i dedikuar për PQH-në, por shërben më tepër për çështje të tjera, që nuk lidhen me PQH-në.
2. Qeveria nuk iu përgjigj grupeve të interesuara mbi mënyrën se si u konsideruan

opinionet e tyre gjatë fazës krijimit të planit të veprimit<sup>4</sup>.

Ju lutemi shikoni Shtojcën I për një përmbledhje të performancës së Shqipërisë në zbatim të Standardeve të Bashkëkrijimit dhe Pjesëmarrjes përmes hartimit të planit të veprimit.

### Tabela [3.2]: Niveli i Ndikimit të Publikut

MPR ka përshtatur nivelin e “Spektrit të Pjesëmarrjes” të Shoqatës Ndërkombëtare për Pjesëmarrje Publike (SHNP2), për të aplikuar për PQH<sup>5</sup>. Ky spektër tregon nivelin e mundshëm të ndikimit të publikut në përmbajtjen e planit të veprimit. Nën shembullin e PQH-së, shumica e vendeve duhet të synojnë për nivelin "bashkëpunues".

Niveli i ndikimit të publikut		Gjatë hartimit të planit të veprimit
Fuqizues	Qeveria i dha publikut fuqi vendimmarrëse.	
Bashkëpunues	Patë dialog ndërveprues dhe publiku ndihmoi në përcaktimin e agjendës.	
Përfshirës	Qeveria dha shpjegime për shqyrtimin e mendimit të publikut.	
Konsultues	Publiku mundi të japë mendimet e tij.	✓
Informues	Qeveria informoi publikun rreth planit të veprimit.	
Pa konsultim	Pa konsultim	

### Forumi shumë-aktorësh

Aktualisht, Shqipëria nuk ka një forum shumë-aktorësh të dedikuar për PQH. Më parë, forumi OpenAlb shërbeu si forumi shumë-aktorësh i vendit. Forumi OpenAlb nuk kishte ndonjë rregull zyrtar të aktivitetit, anëtarësimit, koordinimit ose raportimit. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) koordinoi OpenALB deri në Nëntor 2016, më pas OpenAlb nuk ishte më aktiv. Kjo gjithashtu çoi në një shoqëri civile po aq joaktive gjatë zbatimit të planit të veprimit 2016 - 2018. Duke qenë një mekanizëm i financuar nga donatorët dhe jo një iniciativë qeveritare, përfundimi i financimit çoi në mungesë të qëndrueshmërisë.

Në maj 2018, u krijua nga Zyra e Zëvendëskryeministrit rrjeti i PQH-së i përbërë nga 14 persona kontakti për PQH-në, të emëruara në ministritë e linjës. Rrjeti PQH, një mekanizëm koordinues ndërministror, kontribuoi në zhvillimin e përbashkët të planit të veprimit dhe koordinoi hartimin e angazhimeve përmes ministrive të tyre përkatëse. Sidoqoftë, Rrjeti PQH përbëhet tërësisht nga përfaqësues të qeverisë dhe nuk konsiderohet zyrtarisht një forum shumë-aktorësh sipas udhëzimeve të PQH-së.

### Pjesëmarrja dhe angazhimi gjatë hartimit të planit të veprimit

Siç u përmend më lart, DZHM shërbeu si Sekretariat Teknik i GMPI për MAP, i cili koordinoi procesin për hartimin e planit të veprimit. Midis janarit dhe majit 2018, DZHM përgatiti metodologjinë për zhvillimin e planit të katërt të veprimit. Metodologjia e PQH-së përcaktoi fazat dhe afatet kohore kryesore si dhe kuadrin institucional për përfundimin e planit të veprimit. Nuk kishte pjesëmarrje të shoqërisë civile në hartimin e kësaj metodologjie. Qeveria nuk punoi për rritjen e informimit për të siguruar në këtë proces një numër më të madh aktorësh të cilët operonin në terren. Gjithashtu, faqja kombëtare e PQH-së nuk ishte aktive në vitin 2018 dhe aktorët u informuan rreth procesit të hartimit të planit të veprimit përmes letrave zyrtare dhe postave elektronike<sup>6</sup>.

Më 21 maj 2018, DZHM dërgoi një letër zyrtare pranë ministrive përkatëse të linjës për përcaktimin e personave të kontaktit të PQH-së, të cilët do të bënin lehtësimin e hartimit të planit të veprimit. Nga 11-12 qershorit 2018, DZHM dorëzoi metodologjinë për hartimin e planit të veprimit. Më 25

qershor 2018, u organizua një workshop me pjesëmarrjen e anëtarëve të Rrjetit të PQH-së. Workshopi u përqendrua në hapat që duhen ndjekur për draftimin e planit të veprimit.

Plani i veprimit u hartua në periudhën nga fundi i qershorit deri në fund të gushtit 2018. Ky proces përfshiu hartimin e objektivave dhe prioritetëve për planin, si dhe përgatitjen e dokumenteve përkatëse për buxhetin dhe monitorimin. Nuk disponohen evidenca publike për pjesëmarrjen e shoqërisë civile gjatë kësaj faze të hartimit.

Sipas metodologjisë së planit të veprimit, periudha shtator - nëntor 2018 ishte caktuar për kryerjen e konsultimeve publike të draftplanit. Megjithatë, draft angazhimet nuk u publikuan online dhe sipas informacionit dhënë hulumtuesit të MPR-së, nuk u bë konsultimi me shoqërinë civile për tre nga katër angazhimet e fundit<sup>7</sup>. Qeveria i siguroi studiuesit të MPR-së informacion të përgjithshëm dhe listat e pjesëmarrjeve në aktivitete të ndryshme që lidhen me çështje të anti-korrupsionit dhe qeverisjes së mire, të mbajtura në vitin 2018. Megjithëse qeveria pretendoi se ndihmoi në informimin e zhvillimit të angazhimeve në planin e katërt të veprimit, nuk ka asnjë provë që kjo e fundit u komunikoi të pranishmëve se ata ishin pjesëmarrës në këto aktivitete si pjesë e një konsultimi të dedikuar të PQH-së. Gjithashtu, qeveria nuk i dha studiuesit të MPR-së prova që plani i veprimit të PQH-së ishte në vetvete pjesë e programit ose ishte diskutuar në këto aktivitete<sup>8</sup>. Për më tepër, ndërsa qeveria i siguroi MPR-së prova të kërkesës për dhënie sugjerimesh nga publiku për përmirësime të mundshme të portalit e-Albania si prova konsultimesh për angazhimin 2 (i cili përfshin piketa të dedikuara të portalit e-Albania), këto kërkesa nuk iu komunikuan publikut si pjesë e procesit të zhvillimit të planit të veprimit PQH-së<sup>9</sup>.

Në 9 gusht 2018, personi kryesor i kontaktit për angazhimin 4, dërgoi me e-mail projektin e planit të veprimit dhe ftoi përfaqësuesit e dy OSHC-ve (Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Qendra për Çështje të Informimit të Publikut (INFOCIP)) të japin opinionet e tyre për këtë. Në 6 shtator 2018, u organizua një ëorkshop për OSHC-të me qëllim konsultimin për Angazhimin 4. Në këtë ëorkshop, OSFA dhe INFOCIP paraqitën dy propozime për t'u përfshirë në planin e veprimit, të lidhura veçanërisht me sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë, përmes fuqizimit ligjor dhe rishikimit dhe përmirësimit të ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Këto propozime të bëra nga OSHC-të kryesisht kanë të bëjnë me mirëqeverisjen në sektorin e drejtësisë, por Ministria e Drejtësisë nuk i përfshiu këto propozimet në planin e veprimit përfundimtar<sup>10</sup>. Qeveria nuk i dha shpjegime OSHC-ve se si u shqyrtuan propozimet e tyre. Versioni final i planit të veprimit tregoi se opinionet e dhëna nga shoqëria civile për të përmirësuar Angazhimin 4 nuk ishin përfshirë. Më 21 dhjetor 2018, Zëvendëskryeministri u dërgoi një letër zyrtare personave të kontaktit, duke i informuar ata rreth versionit përfundimtar të planit të veprimit<sup>11</sup>.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të intervistuar të cilët morën pjesë në hartimin e planeve të mëparshme të veprimit konfirmuan që qeveria nuk u këshillua me ta në mënyrën e duhur gjatë zhvillimit të planit të katërt<sup>12</sup>. OSHC-ve nuk u është ofruar një mundësi për të propozuar angazhime dhe aktorët deklaruan që angazhimet u hartuan duke përdorur dokumentet ekzistuese për politikat qeveritare dhe jo mësimet e nxjerra nga hartimi dhe zbatimi i planit të mëparshëm<sup>13</sup>.

Bazuar në intervistat me përfaqësues në ministritë e linjës<sup>12</sup>, angazhimet përfundimtare ishin të paktën pjesërisht të formuluar nga biseda të gjata me OSHC-të aktive për tema në fusha të veçanta. Sidoqoftë, këto diskutime u zhvilluan gjatë konsultimit të dokumentave të tjera strategjike të cilat ishin jashtë procesit të PQH-së<sup>13</sup>. Sipas qeverisë, këto procese tematike konsultimi mbeten pa dyshim të integruara në formulimin e planit të veprimit, por roli i tyre është gjerësisht i padokumentuar. Qeveria Shqiptare - përmes personave kryesorë të kontaktit - pati fjalën e fundit në aprovimin e planit të veprimit, i cili përfshin katër angazhime.

#### [Rekomandime për bashkëkrijimin dhe pjesëmarrjen gjatë hartimit](#)

Pas zgjedhjeve qendrore të vitit 2017 dhe ristrukturimit të ministrive të linjës, nuk kishte kalim të mjaftueshëm të përgjegjësive të PQH-së brenda qeverisë së ristrukturuar. Për shembull, nuk ka pasur një dorëzim të dokumenteve ose trainim të stafit të ri për procedurat e PQH-së.

Për të përmirësuar procesin e bashkëkrijimit për planin e ardhshëm të veprimit, hulumtuesi i MPR-së sugjeron që të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- Është e domosdoshme që Shqipëria të bëjë çdo përpjekje për të rikrijuar një forum shumë-aktorësh me anëtarë nga qeveria dhe shoqëria civile, për të diskutuar dhe vëzhguar proceset e PQH-së në vend. Kjo mund të përfshijë rigjallërimin e forumit OpenAlb, i cili u krijua në vitin 2016, por e humbi funksionin për mungesë financimi. Forumi i ri duhet t'i përshtatet standardeve të PQH-së për Pjesëmarrje dhe Bashkëkrijim<sup>14</sup>. Për shembull, anëtarët joqeveritarë të forumit duhet të zgjidhen përmes një procesi të drejtë dhe transparent dhe forumi duhet t'i paraqesë në mënyrë proaktive vendimet, aktivitetet dhe rezultatet për një masë më të gjerë të aktorëve të qeverisë dhe shoqërisë civile. Forumi shumë-aktorësh duhet të pranojë sugjerime dhe përfaqësime në procesin e planit të veprimit nga çdo organizatë e shoqërisë civile ose aktorë të tjerë jashtë forumit.
- Shoqëria civile nuk u përfshi në përcaktimin e agjendës ose prioritetëve për hartimin e planit të katërt të veprimit për Shqipërinë. Organizatat e shoqërisë civile që u përfshinë në proceset e bashkëkrijimit të planeve të mëparshme të veprimit nuk u përfshinë në procesin e hartimit të planit të katërt. Në hapat e mëtejshëm, DZHM duhet të përfshijë shoqërinë civile që nga fillimi i procesit të bashkëkrijimit dhe të sigurojë që do të ofrohen mundësi të mjaftueshme për të paraqitur propozime dhe komente për projekt-angazhimet. Edhe pse angazhimet në planin e katërt janë bazuar në strategjitë e politikave të mëparshme të njohura nga shoqëria civile, është e paqartë se si plani i veprimit ka pasqyruar prioritetet e shoqërisë civile për agjendën e PQH-së. Për planet e mëtejshme të veprimit, DZHM duhet të angazhohet në më shumë konsultime kushtuar veçanërisht agjendës së PQH-së edhe në rastin kur projekt-angazhimet janë marrë nga strategjitë ekzistuese.
- Për planin e ardhshëm të veprimit, qeveria mund të angazhohet në përpjekje më të gjera për të arritur tek shoqëria civile në të gjithë vendin dhe jo vetëm në kryeqytet. Qeveria gjithashtu mund të sigurojë një planifikim më të gjatë kohor dhe më shumë faza për sugjerime, në procesin e hartimit të planit të veprimit. Informacioni që i përket të gjitha drejtimeve të procesit të hartimit të planit të veprimit të PQH-së<sup>15</sup> duhet publikuar në mënyrë proaktive në faqen kombëtare të internetit të PQH-së (<http://ogp.gov.al/en>).

<sup>1</sup> Evis Qaja, person kontakti për PQH, intervistë nga hulumtuesi i MPR-së, në korrik 2019.

<sup>2</sup> Z. Sanjay Pradhan, letra zyrtare e qeverisë me Nr. 3897 dërguar drejtorit ekzekutiv të PQH-së, datë 27 Gusht 2018.

<sup>3</sup> Letra zyrtare me Nr. 2470 datë 21 Maj 2018, me lëndë: "Për takimin e Koordinatorit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur"; Letra zyrtare me Nr. 2783, datë 11 Qershor 2018, me lëndë: "Për shpërndarjen koordinatoreve të paketës së metodologjisë për hartimin e Planit të Veprimit të PQH-së 2018-2020; Letra zyrtare e qeverisë me Nr. 3004 datë 22 Qershor 2018, me lëndë: "Për dërgimin e paketës së metodologjisë për hartimin e Planit të Veprimit të PQH-së, komponentit kryesor"

<sup>4</sup> Udhëzimi i MPR-së në përmbushjen e pragut minimal "përfshirje", <https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2020/02/IRM-Guidance-Involve.pdf>

<sup>5</sup> "Spektri i Pjesëmarrjes Publike të SHNP2", SHNP2, 2014.

[http://c.yimcdn.com/sites/www.iap2.org/resource/resmgr/foundations\\_course/IAP2\\_P2\\_Spectrum\\_FINAL.pdf](http://c.yimcdn.com/sites/www.iap2.org/resource/resmgr/foundations_course/IAP2_P2_Spectrum_FINAL.pdf)

<sup>6</sup> Letra Zyrtare me Nr. 2783, datë 11 Qershor 2018, me lëndë: "Për shpërndarjen koordinatoreve të paketës së metodologjisë për hartimin e Planit të Veprimit të PQH-së 2018-2020; Letra zyrtare e qeverisë me Nr. 3004 datë 22 Qershor 2018, me lëndë: "Për dërgimin e paketës së metodologjisë për Hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020 të PQH-së, komponentit kryesor"; Letra Zyrtare me Nr. 6003, datë 21 Dhjetor 2018 me lëndë: "Dërgimi i Planit të Ri të Veprimit 2018-2020 në kuadër të partneritetit për qeverisjen e hapur".

<sup>7</sup> Ersida Sefa, OSFA Albania, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së më 23 Korrik 2019. Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv i INFOCIP, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së, 4 Nëntor 2019.

<sup>8</sup> Këto përfundime u vërtetuan nga një rishikim i plotë i dokumenteve të dhëna MPR-së nga pika e kontaktit e qeverisë gjatë periudhës së rishikimit para publikimit të këtij raporti.

<sup>9</sup> Shih: <https://www.facebook.com/ealbania/posts/1980947665267775> and

[https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSe1Gh0hfo\\_8d043HppIHB4I51iAFFxplwuU6wxj00986LgVWPw/viewform?entry.1676994904](https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSe1Gh0hfo_8d043HppIHB4I51iAFFxplwuU6wxj00986LgVWPw/viewform?entry.1676994904).

<sup>10</sup> Raport Përmbledhës përgatitur nga Ministria e Drejtësisë mbi komentet bërë nga OSHC-të në lidhje me draftin e planit të veprimit të PQH-së.

<sup>11</sup> Letra Zyrtare me Nr. 6003, datë 21 Dhjetor 2018 me lëndë: "Dërgimi i Planit të Ri të Veprimit 2018-2020 në kuadër të partneritetit për qeverisjen e hapur".

<sup>12</sup> Ersida Sefa OSFA Albania, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së më 23 Korrik 2019; Auron Pasha Drejtor Ekzekutiv i IDRA (Instituti për Alternativa Zhvillimi dhe Hulumtimi), intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së më 17 Shtator 2019

<sup>13</sup> Ersida Sefa OSFA Albania, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së më, 23 Korrik 2019; Auron Pasha Drejtor Ekzekutiv i IDRA (Instituti për Alternativa Zhvillimi dhe Hulumtimi), intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së më 17 Shtator 2019; Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv i INFOCIP, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së më, 4 Nëntor 2019.

<sup>12</sup> Nevila Repishti Drejtore AKSHI, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së, 17 korrik 2019; Erisa Rodhani, Drejtuese e Njësië, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së, 17 Korrik 2019; Elda Zenelaj Drejtore e Njësië së Antikorrupsionit, Ministria e Drejtësisë, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së, 18 korrik 2019; Evis Qaja, person kontakti për PQH, intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së, korrik 2019.

<sup>13</sup> Angazhimet e PQH-së bazohen në katër dokumente ekzistuese politikë: i. Strategjia e Menazhimit të Financave Publike 2019-2022, veçanërisht objektivi 5 Transparenca e Financave Publike; ii. Agjenda Digjitale 2015-2020 si aktivitete kyçe sipas pëparësisë strategjike “Politika për zhvillimin e E-Gov dhe shpërndarjen shërbimeve publike interactive për qytetarët dhe bizneset”; iii. Strategjia Kombëtare e Ndërlidhjes për reformën e administratës publike 2015-2020, dhe plani veprimi I rishikuar 2018-2020; iv. Strategjia Ndërsektoriale e Shqipërisë për Antikorrupsionin 2015-2020

<sup>14</sup> Standardet e PQH-së për Pjesëmarrje dhe Bashkëkrijim, Partneriteti për Qeveri të Hapur, 2017, <https://bit.ly/2Ov5Fzn>.

<sup>15</sup> Më poshtë keni shembuj të dokumenteve që duhet të vendosen në faqen e internetit: Metodologji për hartimin e planit të veprimit të PQH-së për komponentin drejtues; listë me komponentet drejtuese të PQH-së; dokumente që lidhen me zyrtarë të qeverisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile gjatë procesit të konsultimit të projekt-planit të veprimit; version përfundimtar i planit të veprimit të PQH-së për vitin 2018-2020.

## IV. Angazhimet

Të gjitha qeveritë pjesëmarrëse në PQH hartojnë plane veprimi që përfshijnë angazhime konkrete për një periudhë 2-vjeçare. Qeveritë i nisin planet e tyre të veprimit për PQH-në duke ndarë përpjekjet e tyre të mëparshme lidhur me qeverisjen e hapur, përfshirë strategjitë e veçanta dhe programet në vazhdim. Angazhimet duhet të përshtaten me kushtet dhe sfidat e secilit vend apo subjekt. Angazhimet e PQH-së duhet gjithashtu të përputhen me vlerat e PQH-së të paraqitura në Nenet e Deklaratës së Qeverisjes së Hapur, nënshkruar nga të gjithë vendet anëtare në PQH<sup>1</sup>. Treguesit dhe metoda e përdorur në hulumtimet e MRP-së mund të gjenden në Manualin e Procedurave të MRP-së<sup>2</sup>. Në vijim është një përmbledhje me treguesit kryesorë të MRP-së:

- **Verifikueshmëria:**
  - Jo mjaftueshëm e veçantë për t'u verifikuar: Siç shkruhet në angazhim, a kanë objektivat e deklaruar dhe veprimet e propozuara mungesë qartësie dhe veçantësie që të pengojë që përfundimi i tyre të verifikohet në mënyrë objektive përmes një procesi vlerësues pasues?
  - Mjaftueshëm e veçantë për t'u verifikuar: Siç shkruhet në angazhim, a janë objektivat e deklaruar dhe veprimet e propozuara mjaftueshëm të qarta dhe specifike për të lejuar që përfundimi i tyre të verifikohet në mënyrë objektive përmes një procesi vlerësimi pasues?
- **Lidhja:** Ky variabël vlerëson lidhjen e angazhimeve me vlerat e PQH-së. Bazuar në një lexim të imtësishëm të angazhimeve siç janë shkruar në planin e veprimit, pyetjet udhëzuese për të përcaktuar rëndësinë janë:
  - **Aksesueshmëria në Informacion:** A do të zbulojë qeveria më shumë informacione ose do të përmirësojë cilësinë e informacionit të zbuluar për publikun?
  - **Pjesëmarrja Qytetare:** A do të krijojë apo përmirësojë qeveria mundësitë apo aftësitë e publikut për t'u informuar apo ndikuar në vendime apo politika?
  - **Llogaridhënia Publike:** A do të krijojë apo përmirësojë qeveria mundësitë e përballjes me publikun për t'i bërë zyrtarët përgjegjës për veprimet e tyre?
  - **Teknologji dhe Inovacion për Transparencë dhe Llogaridhënie:** A do të përdoret inovacioni teknologjik në lidhje me një nga tre vlerat e PQH-së për të përparuar si në teknologji ashtu edhe llogaridhënie?
- **Ndikimi i Mundshëm:** Ky variabël akseson ndikimin e mundshëm të angazhimit, nëse zbatohet siç shkruhet. Hulumtuesi i MRP përdor tekstin nga plani i veprimit për:
  - Të identifikuar problemin social, ekonomik, politik, ose mjedisor;
  - Të vendosur status quo-në në fillim të planit të veprimit;
  - Të aksesuar shkallën me të cilën angazhimi, nëse zbatohet, do të ndikojë performancën dhe do të gjurmojë problemin.
- **Përfundimi:** Ky variabël mundëson zbatimin dhe përparimin e angazhimit. Ky variabël është vlerësuar në fund të ciklit të planit të veprimit, në Raportin e Zbatimit të MRP-së.
- **A Mundësoi Qeveri e Hapur?:** Ky variabël përpiket të shkojë përtej matjes së rezultateve dhe shpërndarjes, për të parë se si praktika e qeverisë, në fushat e rëndësishme për vlerat e PQH-së, ka ndryshuar si rezultat i zbatimit të angazhimit. Ky variabël aksesohet në fund të ciklit të planit të veprimit në *Raportin e Zbatimit të MRP-së*.

### Çfarë e bën një angazhim të mundshëm për t'u shënuar me yll?

Një angazhim që ka mundësi të shënohet me yll është më shumë ambicioz dhe i zbatueshëm. Një angazhim i mirë është ai që përshkruan qartë:

1. **Problemin:** Cili është problemi ekonomik, social, politik, ose mjedisor? Dhe të mos bëjë përshkrimin administrativ të çështjes apo mjetit (p.sh., 'Alokimi i gabuar i fondeve të ndihmës sociale' është më e dobishme se sa 'mungesa e faqes së internetit').
2. **Status quo-në:** Cila është status quo-ja për çështjen politike në fillim të një plani veprimi (p.sh., "26 përqind e ankesave për korrupsion në drejtësi nuk janë proceduar aktualisht.")?
3. **Ndryshimin:** Në vend që të konstatoji rezultate të ndërmjetme, cili është ndryshimi i synuar i sjelljes që pritet nga zbatimi i angazhimit (p.sh., "Përgjigja e detajuar ndaj kërkesës

për informacion” ia arrin më mirë qëllimit se sa “të japësh një përgjigje të gatshme nga një protokoll.”)?

### **Angazhimet e shënuar me yje**

Masa e quajtur “angazhim shënuar me yje” (★), meriton më shumë shpjegime për shkak të interesit të veçantë që paraqet për lexuesit dhe dobinë e tij në inkurajimin e një gare për vendin e parë, mes vendeve/subjekteve anëtare të PQH-së. Angazhimet me yje konsiderohen si angazhime me rëndësi të veçantë për PQH-në. Për të marrë një yll, një angazhim duhet të plotësojë disa kritere:

- Yll i mundshëm: hartimi i angazhimit duhet të jetë **i verifikueshëm**, të ketë **lidhje (relevance)** me vlerat e PQH-së dhe duhet të ketë ndikim potencial **transformues**.
- Qeveria duhet të bëjë përpunim të dukshëm në këtë angazhim gjatë periudhës së zbatimit të planit të veprimit dhe të marrë një vlerësim të quajtur zbatim i plotë ose i arrirë (thelbësor).

Ky variabël vlerësohet në fund të ciklit të planit të veprimit, në *Raportin e Zbatimit të MRP-së*.

### **Pasqyrë e përgjithshme e angazhimeve**

Plani i katërt i veprimit për Shqipërinë përfshin katër angazhime:

- Angazhimi 1: Qeverisje e Hapur për të rritur transparencën e raportimit të qeverisë dhe për të përmirësuar aksesin në informacion;
- Angazhimi 2: Qeverisje e Hapur për të Modernizuar Shërbimet Publike dhe Qeverisjen E-Gov;
- Angazhimi 3: Qeverisje e Hapur për 'Better Regulation';
- Angazhimi 4: Qeverisje e Hapur për krijimin e komuniteteve të sigurt;

---

<sup>1</sup> “Partneriteti i Qeverisjes së Hapur: Neni i Qeverisjes,” PQH, qeshor 2012 (Përditësuar në Mars 2014 dhe Prill 2015), [https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/attachments/OGP\\_Articles-Gov\\_Apr-21-2015.pdf](https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/attachments/OGP_Articles-Gov_Apr-21-2015.pdf)

<sup>2</sup> “Manuali i Procedurave, MRP” PQH, <https://www.opengovpartnership.org/documents/irm-procedures-manual>

## I. Qeverisje e Hapur për të Rritur Transparencën në Raportimin e Qeverisë dhe për të Përmirësuar Aksesueshmërinë në Informacion

### Gjuha siç është përdorur në angazhim:<sup>1</sup>

**Objektivi Kryesor:** Objektivi politik i këtij aktiviteti është të garantojë një sistem finance publike që të promovojë transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike, për të përmirësuar cilësinë e shpërndarjes së shërbimeve dhe zhvillimin ekonomik.

### Synimet:

- I.1** Krijimi i një sistemi statistikor që mbulon nevojat e subjekteve buxhetore dhe gjysëm buxhetore.
- I.2** Krijimi i informacionit të standardizuar
- I.3** Krijimi i metodave alternative për grumbullim informacioni
- I.4** Integrimi i Informacionit Shtesë në Sistemin e Thesarit (AGFIS)
- I.5** Integrimi në Modele të Reja për Shkëmbim Informacioni
- I.6** Krahasimi i rezultateve dhe aprovimi i informacionit të ri
- I.7** Hartimi i një deklaratë të detajuar të risqeve fiskale dhe përfshirja në dokumentacionin e buxhetit
- I.8** Monitorimi i institucioneve publike në lidhje me zbatimin e kërkesave të MFK
- I.9** Aplikimi i fondeve të MFK-së në subjektet e sektorit publik

Data e Fillimit: 2014

Data e Perfundimit: 2022

Paraqitja e Angazhimeve	Verifikueshmëria		Lidhja (Relevanca) e Vlerës së PQH (siç është e shkruar)				Ndikimi i Mundshëm				Perfundimi				A Mundësoi Qeveri të Hapur?			
	Jo mjaftueshëm specifik për t' u verifikuar	Mjaftueshëm specifik për t' u verifikuar	Akses në Informacion	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie Publike	Teknologji & Inovacion për Transparencë & Llogaridhënie	Asnjë	Pak	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I Përfunduar	Përqesoi	Nuk ndryshoi	E kufizuar	Konsiderueshem
I. Përmbledhje		✓	✓					✓			Akses në fund të ciklit të planit të veprimit				Akses në fund të ciklit të planit të veprimit			

### Konteksti dhe Objektivat

Ky angazhim lidhet me Menaxhimin e Financave Publike (MFP)<sup>2</sup> për Shqipërinë 2014 - 2020 dhe kërkon ta bëjë sistemin e financave publike në vend, më transparent dhe efikas. Sipas një specialisti të



intervistuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT), kuadri ligjor i Shqipërisë për infrastrukturën statistikore është pjesërisht në përputhje me Kodin e Praktikave Statistikore Evropiane dhe klasifikimet janë në linjë me standardet e BE-së. Shqipëria ka adoptuar në shkurt të vitit 2017, një program pesëvjeçar për statistikat zyrtare për periudhën 2017 - 2021, por ende nuk ka një plan të detajuar veprimi. Gjithashtu, buxheti i INSTAT-it dhe stafi nuk janë në lartësinë e duhur për të zbatuar plotësisht programin “EU acquis” në statistika<sup>3</sup>.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) bën të mundur aksesin e publikut në të dhënat e buxhetit. Ajo ka krijuar një “Portal për Transparencë” në faqen e saj të internetit, në lidhje me financat lokale dhe publikon gjithashtu dokumente të ndryshme të rëndësishme lidhur me buxhetin. Sipas Sondazhit për Buxhetin e Hapur 2017<sup>4</sup>, të Partneritetit Ndërkombëtar të Buxhetit, Shqipëria mori 50 pikë nga 100 të mundshme për transparencën e buxhetit (pak më e lartë se mesatarja globale)<sup>5</sup>. Që në vitin 2017, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur dhe publikuar raportin 6-mujor<sup>6</sup>. Veç kësaj është bërë përparim në rritjen e ndërgjegjësimit për llogaridhënien menaxheriale, perdorimin e manualeve të kontrollit të jashtëm në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe vendosjen e masave të kontrollit të cilësisë. Megjithatë, disa institucione nuk e zbatuan plotësisht legjislacionin e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP) dhe shkalla e zbatimit të rekomandimeve të kontrollit të brendshëm e të jashtëm mbetet e ulët<sup>7</sup>.

Ky angazhim përfshin një seri aktivitete që mund të ndihmojnë INSTAT-in që të mbyllë disa hendeqe mes legjislacionit dhe praktikave statistikore në Sistemin Statistikor të Statistikave Financiare Qeveritare (SFQ). Kjo mund të ndihmojë të krijohet një sistem statistikor transparent dhe i pavarur që jep të dhëna aktuale dhe të besueshme nga Statistikat Financiare Qeveritare (SFQ). Kjo gjithashtu mund të ndihmojë që Shqipëria të jetë në përputhje me standardet e BE-së, si Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale të BE-së (ESA 2010)<sup>8</sup>. Angazhimi është në lidhje me vlerat e PQH-së për akses në informacion, duke kërkuar të përmirësojë transparencën e statistikave qeveritare në zbatimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit efikas të fondeve publike. Arritjet janë të matshme. Për shembull, kushdo mund të shohë nëse një sistem statistikor është krijuar, nëse është përfshirë informacioni shtesë në Sistemin e Thesarit dhe nëse janë dhënë deklarata të detajuara të risqeve fiskale.

Sipas një raporti të Reformës së Administratës Publike (RAP) të vitit 2017, ka nevojë të përmirësohet transparenca dhe kuptueshmëria e raportimit dhe shqyrtimit të buxhetit në Shqipëri<sup>9</sup>. Ky angazhim mund të ndihmojë të krijohet një sistem statistikor më transparent dhe i pavarur që jep të dhëna aktuale dhe të besueshme nga Statistikat Financiare Qeveritare (SFQ). Kjo gjithashtu mund të ndihmojë që Shqipëria të jetë në përputhje me standardet e BE-së, si Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale të BE-së (ESA 2010)<sup>10</sup>. Gjatë monitorimit të vazhdueshëm të stafit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2018, është vënë re që institucionet kanë krijuar tashmë kushtet e nevojshme për kontroll efikas me të gjithë elementët e tij përbërës, por ka disa probleme në sistemin MFK. Këto përfshijnë procesin e menaxhimit të riskut, mungesë e dokumentimit të saktë të rrjedhës së procesit të punës dhe mungesë e procedurave të shkruara që kanë të bëjnë me formën e raportimit brenda institucionit dhe njësisë të varësisë<sup>11</sup>. Nëse zbatohen plotësisht pikat kryesore 1.7 - 1.9, mund të kontribuojnë për të përmirësuar performancën në zbatimin e një sistemi MFK të brendshëm. Sidoqoftë, duke pasur parasysh mungesën e treguesve të detajuar të performancës për pikat kryesore, ndikimi i përgjithshëm potencial i angazhimit konsiderohet i vogël

### **Hapa të mëtejshëm**

Përmirësimi i statistikave qeveritare, zbatimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi efikas i fondeve publike mund të sigurojnë një bazë të rëndësishme për një llogaridhënie më të madhe. Për zbatim efektiv të këtij angazimi, hulumtuesi i MPR-së rekomandon që MFE të ofrojë në faqen e internetit të PQH-së së Shqipërisë informacion mbi risitë institucionale dhe mësimet e nxjerra. Përtej planit të veprimit aktual, hulumtuesi i MPP-së rekomandon si më poshtë:

- Të publikohen të dhëna të hapura rreth statistikave qeveritare në faqen e internetit të PQH-së shqiptare, përmes dritares “Të Dhëna të Hapura”;
- Të publikohet informacion rreth performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar, duke përfshirë të dhënat financiare të institucioneve publike;

- Të sigurohen mundësi zyrtare për publikun që të angazhohet në proceset buxhetore në mënyrë që të hartohet një buxhet më i strukturuar dhe me angazhim qytetar dhe;
- Të sigurohen veprime dhe mjete për të matur nivelin e kënaqësisë së qytetarëve me shpërndarjen e shërbimeve publike;

---

<sup>1</sup> Për tekstin e plotë të këtij angazhimi, shihni: "Partneriteti i Qeverisë së Hapur Plani Kombëtar i Katër i Veprimit i Qeverisë së Hapur për Shqipërinë 2018-2020", Partneriteti i Qeverisë së Hapur, 10 Janar

2019, [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/01/Albania\\_Action-Plan\\_2018-2020\\_EN.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/01/Albania_Action-Plan_2018-2020_EN.pdf)

<sup>2</sup> "Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike në Shqipëri 2014-2020", Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, Dhjetor 2014, [https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/09/Albanian\\_PFM\\_strategy\\_2014-2020-1.pdf](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/09/Albanian_PFM_strategy_2014-2020-1.pdf)

<sup>2</sup> Vjollca Simoni specialiste në Institutin e Statistikave (INSTAT), intervistuar nga hulumtuesi i MPR-së, 17 korrik 2019

<sup>4</sup> "Vëzhgimi i Buxhetit të Hapur 2017", Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit, Janar

2018, <https://www.internationalbudget.org/wp-content/uploads/open-budget-survey-2017-report-english.pdf>

<sup>5</sup> "Vëzhgimi i Buxhetit të Hapur 2017", Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit, <https://www.internationalbudget.org/wp-content/uploads/albania-open-budget-survey-2017-summary.pdf>

<sup>6</sup> Shih: <https://financa.gov.al/raporti-i-mes-vitit-mbi-zbatimin-e-buxhetit-2018/>

<sup>7</sup> "Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2018", Komisioni Europian, 17 Prill

2018, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

<sup>8</sup> "Rreth ESA 2010", Eurostat, Komisioni Europian <https://ec.europa.eu/eurostat/web/esa-2010>

<sup>9</sup> "Parimet e Administratës Publike: Shqipëria", SIGMA, OECD, Komisioni Europian, Nëntor

2017, <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2017-Albania.pdf>

<sup>10</sup> [njwji burim](#)

<sup>11</sup> Të dhëna grumbulluar nga pyëtesori plotësuar nga stafi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Kjo i referohet raportit të vlerësimit të vitit 2018 mbi funksionimin sistemit MFK në institucionet publike.

## 2. Qeverisje e Hapur për të Modernizuar Shërbimet Publike dhe E-Gov

**Gjuha e përdorur është ajo e angazhimit!**

**Objektivi Kryesor:** Qëllimi politik i këtij aktiviteti është zhvillimi i një qeverisje elektronike dhe kushtet për shërbime publike ndërvepruese për qytetarët dhe bizneset.

**Synimet:**

**2.1.1** Ngritja e seksionit të informacionit në Partneritetin e Qverisjes së Hapur (OGP)

**2.1.2** Ngritja e seksionit "Të dhëna të Hapura" për transparencë në aktivitetin e institucioneve publike

**2.1.3** Identifikimi dhe grumbullimi i të dhënave në formatin e duhur nga institucionet e administratës publike

**2.1.4** Hedhja e të dhënave në portal

**2.2.1** Zbatimi i shërbimeve të reja elektronike në portalin e-Albania

**2.2.2** Ekspozimi i të dhënave për Platformën Ndërvepruese Qeveritare

Data e Fillimit: 2018

Dat e Mbarimit: 2020

Paraqitja e Angazhimeve	Verifikueshmëria		Lidhja Relevanca e PQH (siç është shkruar)				Ndikimi i Mundshëm				Përfundimi				A Mundësoi Qeveri të Hapur?			
	Jo mjaftueshëm specifik për t' u verifikuar	Mjaftueshëm specifik për t' u verifikuar	Akes në Informacion	Pjesëmarrje Qytetare	Llogaridhënie Publike	Teknologji & Inovacion për Transparencë & Llogaridhënie	Asnjë	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar	I Kufizuar	I Konsiderueshëm	I Përfunduar	Përkeqësoi	Nuk e Ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm
2. Përmbledhje		✓	✓			✓			✓		Vlerësuar në fund të ciklit të planit të veprimit.				Vlerësuar në fund të ciklit të planit të veprimit.			

### Konteksti dhe Objektivat

Ky angazhim është i lidhur me Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2015 - 2020<sup>2</sup> dhe ka për qëllim të zhvillojë më tej shërbimet elektronike për qytetarët dhe bizneset në Shqipëri. Aktualisht, 591 shërbime qeveritare nga 1,600 në total, janë të disponueshme në mënyrë elektronike në portalin e-Albania<sup>3</sup>. Ministritë e Linjës dhe agjensitë në varësi u kanë dhënë përparësi disa shërbimeve për t'u digjitalizuar, bazuar në ato që përdoren më shumë dhe/ose kërkuar nga përdoruesit, sipas një sondazhi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)<sup>4</sup>. Megjithatë, ka akoma shumë shërbime publike për të cilat qytetarëve u kërkohet të shkojnë personalisht në zyrat e shtetit, që është shpenzim kohe dhe e kushtueshme, veçanërisht për qytetarë që banojnë në zona të largëta të vendit<sup>5</sup>. Prandaj, një element thelbësor në kuadër të shërbimit elektronik qeveritar në Shqipëri është që të gjithë dokumentet administrative (si certifikata, vërtetime apo dëshmi) të kenë të njëjtën vlerë ligjore si kur merren online ashtu edhe kur merren personalisht. Që nga legjitimimi i vulës

elektronike në shtator 2017,<sup>6</sup> portali e-Albania bën të disponueshëm dokumente të rëndësishme ligjore, pavarësisht orareve të zyrave publike.

Qeveria e Shqipërisë nuk ka aktualisht një portal kombëtar me të dhëna të hapura<sup>7</sup>. Bazuar në Ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën për Informim", agjencitë qeveritare do të bëjnë të disponueshme për publikun, në faqet e tyre të internetit, kategori të caktuara informacioni. Ky informacion do të identifikohet nga të gjithë subjektet publike që do të publikojnë të dhënat e tyre specifike në portal.

Për të adresuar këto çështje, ky angazhim propozon të krijohet portal kombëtar me të dhëna të hapura, i cili do të përfshihet në një faqe të dedikuar interneti të PQH-së. Ky gjithashtu bën thirrje që shërbime të reja elektronike të bëhen të disponueshme në portalin e-Albania. Ky angazhim është i lidhur me vlerat e PQH-së, siç është aksesimi në informacion dhe teknologjia e inovacioni për llogaridhënie transparente. Ky përfshin aktivitete që janë të verifikueshme. Aktualisht, janë 33 dokumente elektronike që ofrohen në portal, disa nga të cilat ofrohen vetëm elektronikisht<sup>8</sup>. Sipas Drejtorit të marrëdhënieve të E-Gov me institucionet e Agjencisë Kombëtare të Shërbimit të Informacionit (AKSHI), zbatimi i këtij angazhimi do të bëjë të disponueshme 100 shërbime të reja në këtë portal<sup>9</sup>.

Mbi të gjitha, ky angazhim mund të përmirësojë aksesueshmërinë në informacion rreth shërbimeve publike, përmirësojë nivelin e ndërgjegjësimit publik për procedurat e shpërndarjes së shërbimit publik dhe ndihmon në reduktimin e kohës së pritjes për qytetarët në zyrat e agjencive publike<sup>10</sup>. Sipas Drejtorit të marrëdhënieve të E-Gov me institucionet e AKSHI-it, numri i certifikatave që do të jepen në sportelet e zyrave do të ulet tre herë, duke i kursyer qytetarëve mbi 50,000,000 Lekë në përgjithësi, gjithashtu pajisja online me certifikatat e taksave do t'i kursejë bizneseve një kohë prej 91,000 orësh qëndrimi në radhë dhe do të evitojë veprime të tjera burokratike që sjell kosto shtesë për bizneset<sup>11</sup>. Veç kësaj, ulja e orëve të pritjes në zyrat e agjencive publike dhe ulja e nevojës për dokumente të printuara nga ana e qytetarëve, mund të ndihmojë në uljen e rrezikut të korrupsionit.

Përfitimet nga krijimi i portalit kombëtar qeveritar me të dhëna të hapura janë disa, që nga përmirësimi i efikasitetit të administratës publike, tek rritja ekonomike e sektorit privat. Bazuar në legjislacionin shqiptar<sup>12</sup>, të dhënat do të parapërgatiten në formate të kuptueshëm lehtësisht dhe të aksesueshëm dhe do të jenë publikisht të disponueshëm online. Ky angazhim gjithashtu bën thirrje për krijimin e një faqeje interneti dedikuar PQH-së, me informacion zyrtar mbi procesin e PQH-së në Shqipëri<sup>13</sup>. Kjo mund të përmirësojë aksesin në informacion mbi procesin e PQH-së në Shqipëri. Një faqe e tillë interneti nuk ekzistonte në kohën e hartimit të planit aktual të vepimit.

## Hapa të Mëtejshëm

Të dhëna të hapura dhe platforma shërbimi elektronik janë mekanizma të rëndësishëm për të përmirësuar shpërndarjen e shërbimeve dhe për të rritur aksesin në informacion. Për një zbatim efikas të angazhimit, hulumtuesi i MPR-së rekomandon të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- Qeveria dhe aktorët e interesuar mund të kryejnë një fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit për portalin e ri me të dhëna të hapura.
- Qeveria mund të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të mekanizmit të opinioneve, në mënyrë që të dhënat të bëhen më të kuptueshme për publikun e gjerë dhe
- Qeveria mund të përcaktojë një seri treguesish të zbatimit, të rezultatit të arritur dhe ndikimit nga kjo performancë për të gjurmuar efektshmërinë e zbatimit të angazhimit. Tregues të tillë mund të përfshijnë:
  - Numri në rritje i vizitorëve unikë vjetorë apo mujorë në faqen e internetit të PQH-së;
  - Numri në rritje i publikut (qytetarë, komunitet biznesi) që përdor platformën me të dhëna të hapura;

<sup>1</sup> Për tekstin e plotë të këtij angazhimi, shihni: "Partneriteti i Qeverisë së Hapur Plani Kombëtar i Katër i Veprimit i Qeverisë së Hapur për Shqipërinë 2018-2020", Partneriteti i Qeverisë së Hapur, 10 Janar 2019, [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/01/Albania\\_Action-Plan\\_2018-2020\\_EN.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/01/Albania_Action-Plan_2018-2020_EN.pdf)

<sup>2</sup> "Strategjia Ndërsektorale - Agjenda Digjitale e Shqipërisë" 2015-2020 ", Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike , [http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Digital\\_Agenda\\_Strategy\\_2015\\_-\\_2020.pdf](http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Digital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf)

<sup>3</sup> "Home", e-Albania, <https://e-albania.al/>

<sup>4</sup> Nevila Repishti Drejtore e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së, 17 korrik 2019; Emiliano Lule përfaqësues i komunitetit të të verbërve, intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së, 22 korrik 2019; Neki Hoxha përfaqësuese e Grupit të të Rinjve, intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së, 22 korrik 2019.

<sup>5</sup> Pyetsor kryer nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), korrik 2019

<sup>6</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 13 shtator 2017, "Mbi adoptimin e rregullave për përfitime nga shërbimet elektronike publike",

<sup>7</sup> Evis Qaja, person kontakti për PQH-në, intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së, korrik 2019

<sup>8</sup> Nevila Repishti Drejtore e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së, 17 korrik 2019;

<sup>9</sup> Marseda Prifti Drejtore e marrëdhënieve të E-Gov me institucione, AKSHI, intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së, 17 korrik 2019.

<sup>10</sup> Nevila Repishti , I njëjtë;

<sup>11</sup> Marseda Prifti Drejtore e marrëdhënieve të E-Gov me institucione për AKSHI-n, intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së, 17 korrik 2019.

<sup>12</sup> Ligji nr. 119/2014, "Mbi të Drejtën për Informacion",

<sup>13</sup> Evis Qaja, I njëjtë

### 3. Qeverisje e Hapur për “Better Regulation”

#### Gjuha e përdorur është si në angazhim:<sup>1</sup>

**Objektivi Kryesor:** Objektivi politik i këtij aktiviteti është zhvillimi i një administrate publike që të sigurojë shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në një mënyrë transparente, të efektshme dhe të plotë, përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhjeve me kërkesat e integritimit evropian, përmes nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë të strukturave efikase. Një sistem politikëbërjeje transparent dhe gjithëpërfshirës i cili siguron përputhshmëri me acquis

#### Synimet:

- 3.1** Hartimi i një metodologjie për përgatitjen e dokumenteve strategjike (strategji, programe, plane veprimi, dokumente politikash etj.).
- 3.2** Hartimi i një pakete ligjore për funksionimin e sistemit IPSIS
- 3.3** Përmirësimi i kapacitetit të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & ministritë e linjës lidhur me monitorimin e politikave, strategjive, planeve të veprimit, programet e zhvillimit në përputhje me metodologjitë IPSIS & AFMIS.
- 3.4** Rishikimi i Bazës Ligjore dhe Kuadrit Rregullator për Funksionimin e IPMG-ve dhe/ose SWG-ve për të Adresuar Sfidat në Strukturat Qeverisëse dhe Ndryshim të Funksioneve.
- 3.5** Përgatitje të formateve standarde (tool kit) për funksionimin IPMG për Mirëqeverisje & Udhëzime Operacionale/Progresi IPMG (rishikimi i kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisje)
- 3.6** Funksioni sistematik i Grupit Tematik të Politikëbërjes dhe ngritja e rrjetit për politikëbërje me njësitë e politikave në ministritë e linjës.
- 3.7** Përgatitja e Udhëzuesit Operacional për ministritë e linjës për kryerjen e procesit të konsultimit publik dhe funksionimin e regjistrit elektronik për konsultimin publik.
- 3.8** Trainim/Ngritje Kapacitetesh për Stafin Përgjegjës në Ministritë e Linjës për Përdorimin Platformës elektronike të Konsultimit Publik
- 3.9** Monitorim i rregullt për zbatimin e procesit të konsultimit publik
- 3.10** Vendosje rregullash që e bëjnë të detyrueshëm zbatimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit
- 3.11** Forcimi i kapaciteteve, përmes tranimeve të ndryshme të punonjësve (Rrjeti RIA) në ministritë e linjës dhe zyrën e Kryeministrit, në mënyrë që të përmirësohet procesi i vlerësimit të rregullt të ndikimit
- 3.12** Përmirësimi i procesit të planifikimit të hartimit të akteve ligjore duke përcaktuar afatet dhe rregullat e procesit të hartimit të PPAP.

Data e Fillimit: 2018

Data e Përfundimit: 2020

Paraqitja e Angazhimit	Verifikueshmëria		Lidhja (relevanca) e Vlerës së PQH (siç është shkruar)				Ndikimi i Mundshëm				Përfundimi				A Mundësoi Qeveri të Hapur?				
	Jo mjaftueshëm specifik për t' u verifikuar	Mjaftueshëm specifik për t' u verifikuar	Akses në Informacion	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie publike	Teknologji & Inovacion për Transparencë & Llogaridhënie	Asnjë	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
3. Përmbledhje		✓	✓	✓			✓				Vlerësimi në fund të ciklit të planit të veprimit				Vlerësimi në fund të ciklit të planit të veprimit				

### Konteksti dhe Objektivat

Ky angazhim synon të përmirësojë administratën publike të Shqipërisë, në mënyrë që të sigurojë shërbime cilësore për qytetarët dhe bizneset në një mënyrë transparente. Ai gjithashtu synon të sigurojë që administrata publike e Shqipërisë të jetë në përputhje me kërkesat e integritetit në BE, duke siguruar që nëpunësit civilë të jenë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm.

Aktualisht, qeveria e Shqipërisë përgatit dokumente të ndryshme të planifikimit qendror dhe raporte monitorimi, por jo të gjitha janë të disponueshme për publikun dhe për përgatitjen e tyre janë përdorur standarde të ndryshme. Veç kësaj, Shqipëria nuk ka ndonjë proces sistematik për të kryer analizat e duhura mbi ndikimin e politikave dhe ligjeve të reja. Përmirësime për cilësinë e politikëbërjes dhe analizat janë të rëndësishme, për shembull, një nga këto përmirësime do të ishte sigurimi që Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik i vitit 2014 është zbatuar plotësisht duke prezantuar Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) në të gjitha ministritë<sup>2</sup>. Në qershor 2017, Kryeministri aprovoi një metodologji për të drejtuar Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) në ministri të zgjedhura, por nuk ka plan për të institucionalizuar plotësisht RIA-n brenda sistemit aktual të politikëbërjes. Gjithashtu, përveç adoptimit të ligjit të ri për konsultimin publik dhe krijimin e një platforme elektronike në vitin 2016, konsultimi me aktorë të jashtëm për politikën e reja, shpesh nuk janë integruar në procesin e përgjithshëm të politikëbërjes<sup>3</sup>.

Ky angazhim përfshin aktivitete që synojnë të përmirësojnë konsultimet publike, duke përfshirë platformën e konsultimit publik [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al), e cila lidhet me vlerën e PQH-së për pjesëmarrjen qytetare. Gjithashtu, publikimi i përgatitjeve, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe kuadrit rregullator, lidhen me aksesin në informacion.

Nëse zbatohet plotësisht, ky angazhim do të mund të ndihmonte në sigurimin e standardeve, qasjeve dhe mjeteve të unifikuara, në përgatitjen e raporteve, dokumenteve strategjike dhe rishikimin e kudrit ligjor. Ai gjithashtu do të mund të forconte kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë në kryerjen e konsultimeve publike (Synimet 3.1 – 3.8). Procesi i duhur i konsultimit publik dhe publikimi në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe kuadrit rregullator, mund të sigurohet përmes synimit 3.9, megjithëse kjo pikë nuk përshkruan se si do të bëhet. Arritja e synimit 3.10-3.12 mund të sigurojë procesin ose metodologjinë sistematike për kryerjen e analizave të ndikimit të ligjeve dhe politikave të reja. Ndërsa dokumentet e mira strategjike mund të krijojnë parakushtet themelore për konsultimet publike, zbatimi i tyre do të sigurojë të kuptuarit më të qartë të ndikimit të tyre në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Mungesa e detajeve në planin e veprimit për aktivitetet e bën të vështirë vlerësimin e ndikimit të tyre maksimal.

### Hapa të mëtejshëm

Duke vazhduar më tej me publikimin e projekt-ligjeve ose planeve të veprimit për konsultime publike, qeveria mund të përcaktojë afate kohore të përshtatshme, të krijojë rregulla të qarta dhe të japë opinione për kontributin e dhënë nga qytetarët. Ligji mbi njoftimet dhe konsultimet publike mund të ndryshohet për të përfshirë aktet administrative (psh. akte nënligjore).

<sup>1</sup> Per tekstin e plote te ketij angazhimi, shihni: "Partneriteti i Qeverisë së Hapur Plani Kombëtar i Katër i Veprimit i Qeverisë së Hapur për Shqipërinë 2018-2020", Partneriteti i Qeverisë së Hapur, 10 Janar

2019, [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/01/Albania\\_Action-Plan\\_2018-2020\\_EN.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/01/Albania_Action-Plan_2018-2020_EN.pdf)

<sup>2</sup> "Parimet e Administratës Publike: Shqipëria", SIGMA, OECD, Komisioni Europian, Nëntor

2017, <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2017-Albania.pdf>

<sup>3</sup> [I njëjti burim](#)



## 4. Qeverisje e Hapur për krijimin e komuniteteve të sigurt

### **Synimet:**

Qëllimi politik i këtij aktiviteti është të kontrollojë dhe denoncojë praktikën korruptive në institucionet publike nga Grupi Punës Kundër Korrupsionit.

- 4.1.1** Ngritja e grupeve të kontrollit
- 4.1.2** Hartimi i një kalendari/plani kontrolli
- 4.1.3** Kryerja e kontrolleve në institucionet publike
- 4.1.4** Gjetja/përpilimi i raportit të kontrollit
- 4.1.5** Masat e propozuara

Qëllimi politik i këtij aktiviteti është të rrisë transparencën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (K4KK) në monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Antikorrupsion Ndërsektorial.

- 4.2.1** Komunikimet online të K4KK për rastet e kontrolleve të Task Forces Kunder Korrupsionit
- 4.2.2** Publikimi and Aksesueshmëria e publikut dhe grupeve të interesuara për gjetjet nga kontrollet e kryera

Qëllimi politik i këtij aktiviteti është të inkurajojë qytetarët të përdorin mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit

- 4.3.1** Raportimi Periodik i ADB<sup>2</sup> për denoncimet në platformë

Qëllimi politik i këtij aktiviteti është të përmirësojë trajtimin e denoncimeve kundër korrupsionit.

- 4.4.1** Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve kundër korrupsionit

Qëllimi politik i këtij aktiviteti është të forcojë mekanizmat antikorrupsion dhe të parandalimit të tij.

- 4.5.1** Përfundimi i procedurës së prokurimit dhe firmosja e kontratës për zhvillimin e software-it
- 4.5.2** Përfundimi i procedurës së prokurimit dhe firmosja e kontratës për infrastrukturën e hardware-it
- 4.5.3** Hartimi i Software-it
- 4.5.4** Zhvillimi i sistemit dhe ndërtimi i infrastrukturës
- 4.5.5** Zbatimi, virtualizimi/përfundimi i instalimit të sistemit të operimit

Data e Fillimit: 2018

Data e Përfundimit: 2020

Paraqitja e Angazhimeve	Verifikueshmëria		Lidhja (Relevanca) e Vlerës së PQH-së (siç është e shkruar)				Ndikimi i Mundshëm				Përfundimi				A Mundësoi Qeveri të Hapur?				
	Jo mjaftueshëm specifik për t' u verifikuar	Mjaftueshëm specifik për t' u verifikuar	Akses në Informacion	Pjesëmarrje Qytetare	Llogaridhënie Publike	Teknologji & Inovacion për Transparencë & Llogaridhënie	Asnjë	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I Përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
4. Përmbledhje		✓	✓		✓	✓								Vlerësuar në fund të ciklit të planit të veprimit.	Vlerësuar në fund të ciklit të planit të veprimit.				

### Konteksti dhe Objektivat

Ky angazhim synon të forcojë institucionet dhe mekanizmat antikorrupsion në Shqipëri duke:

- rritur efektshmërinë e dy organizmave kryesore kundër korrupsionit të Shqipërisë, Grupit të Punës Kundër Korrupsionit dhe Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konflikteve të Interesit (ILDKPKI),
- rritur transparencën e Koordinatorit Kunder Korrupsionit (KKK),
- monitoruar zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit Ndërsektorial<sup>3</sup>,
- nxitur qytetarët të përdorin mekanizmat për denoncimin e korrupsionit si platforma [www.shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al) dhe të përmirësojë trajtimin e këtyre denoncimeve.

ILDKPKI është organizmi kryesor përgjegjës për grumbullimin e deklaratave të pasurisë dhe identifikimin e konflikteve të interesit, kurse Grupi i Punës Kundër Korrupsionit është një organizëm administrativ që trajton dhe heton mbi denoncimet e korrupsionit. Grupi i Punës, si pjesë e kontrolleve, jep propozime për KKKK-në për përmirësimin ligjor ose adresimin e praktikave korruptive.

Roli i ILDKPKI-së në zbulimin e konflikteve të interesit dhe kontrollin e deklaratave të pasurisë, është forcuar me miratimin e Ligjit për mbrojtjen e informimit dhe informatorit në vitin 2016. Veç kësaj, ILDKPKI luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e Ligjit për procesin e përkohshëm të rivlerësimit. Megjithatë, sipas Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, e vitit 2018, kapaciteti financiar, teknik dhe administrativ duhet të forcohet më tej që të arrijë të bëjë kontrollet e deklaratave të pasurisë<sup>4</sup>. Për më tepër, në kohën kur u dorëzua ky plan veprimi, Shqipëria akoma nuk kishte krijuar një sistem të deklarimit online të deklaratës së pasurisë.

Ky angazhim propozon një sërë aktivitete që e lidhin atë me vlerën e llogaridhënies publike të PQH-së, sepse aktivitetet synojnë të përmirësojnë trajtimin e denoncimeve qytetare për korrupsionin. Ai gjithashtu lidhet me aksesin në informacion, i cili vjen si rezultat i publikimit të propozuar të informacionit për rastet e korrupsionit me mjetet audio-vizuale dhe mes të tjerash edhe krijimin e një sistemi të deklarimit të pasurisë online. Arritjet e këtij angazhimi janë të verifikueshme.

Ngritja e grupeve të kontrollit, përgatitja e raporteve të inspektimit dhe publikimi i tyre mund të përmirësojë kuadrin antikorrupsion në Shqipëri, megjithëse vetëm këto aktivitete nuk janë të mjaftueshme për të dënuar rastet e raportuara të korrupsionit. Grupet e kontrollit mund të ndihmojnë KKKK-në të grumbullojë, analizojë, monitorojë dhe gjurmojë të dhënat e rasteve të korrupsionit. Në kohën e hartimit të planit të veprimeve, zyrtarët publikë dorëzuan dorazi në ILDKPKI, deklaratat e pasurisë. Duke ngritur një sistem të

Versioni për koment publik: Ju lutemi mos citoni

deklarimit online të deklaratës së pasurisë, Shqipëria bën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe verifikimit të interesave private të zyrtarëve. Deklaratat e pasurisë mund të verifikohen më shpejt, më me efektivitet dhe me më shumë transparencë. Për këtë arsye, angazhimi mund të ketë një ndikim të mundshëm mesatar në përgjithësi.

### Hapa të mëtejshëm

Për zbatim efikas të angazhimit, MPR sugjeron si më poshtë:

- Të sigurohet publikimi i të dhënave të sistemit të gjurmimit të rasteve korruptive në institucionet publike (duke marrë parasysh mbrojtjen e nevojshme të të dhënave dhe konfidencialitetin).
- Riaktivizimi i sistemit ekzistues me bazë në internet për statistika të harmonizuara dhe gjurmimin e rasteve të korrupsionit, quajtur [www.act-albania.al](http://www.act-albania.al). Përdorimi i këtij sistemi mund të ndihmojë KKKK-në të grumbullojë të dhëna korrupsioni përmes formularëve të aplikimit, analizave, monitorimit dhe gjurmimit të të dhënave të rasteve të korrupsionit në institucionet publike, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e raportimit të zyrës së KKKK-së.
- Qeveria mund të kryejë një fushatë ndëgjegjësimi publik në lidhje me funksionimin e sistemit online të deklarimit të pasurisë.
- Të publikojë informacion me përmbajtje të raporteve që gjenerohet nga sistemi online i deklarimit të pasurisë përmes publikimit të tyre në portalin e ri me të dhëna të hapura (nën angazhimin 2).

---

<sup>1</sup> Per tekstin e plote te ketij angazhimi, shihni: "Partneriteti i Qeverisë së Hapur Plani Kombëtar i Katërt i Veprimit për Qeverinë e Hapur për Shqipërinë 2018-2020", Partneriteti i Qeverisë së Hapur, 10 Janar [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/01/Albania\\_Action-Plan\\_2018-2020\\_EN.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/01/Albania_Action-Plan_2018-2020_EN.pdf).

<sup>2</sup> Agency for Dialogue and Co-Government (Agiensia për Dialog dhe Bashkëqeverisje)

<sup>3</sup> "Pasaporta e Treguesve: Strategjia ndër-sektorale kundër korrupsionit (Shqipëri)", ARS, [http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/passport\\_indicators.pdf](http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/passport_indicators.pdf)

<sup>4</sup> "Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2018", Komisioni Europian, 17 Prill 2018, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>.

## V. Rekomandime të Përgjithshme

Ky seksion synon të informojë hartimin e planit të ardhshëm të veprimit dhe të japë udhëzime për zbatimin e planit aktual të veprimit. Ai ndahet në dy sektorë: 1) Rekomandimet e rëndësishme të MPR-së për të përmirësuar procesin PQH dhe planet e veprimit për vendin apo subjektin dhe 2) një vlerësim se si u është përgjigjur qeveria rekomandimeve të rëndësishme të mëparshme të PQH-së.

### 5.1 Rekomandimet MPR-së

**Mbështetje në Standardet e Pjesëmarrjes dhe Bashkëkrijimit të PQH-së**  
MRP përsërit një rekomandim nga Raporti i Progresit të MPR-së për planin e mëparshëm të veprimit të Shqipërisë (2016-2018) që qeveria duhet t'ia bashkëngjisë Standardeve të Pjesëmarrjes dhe Bashkëkrijimit të PQH-së, kur harton planet e veprimit. Nën shembullin e PQH-së, qeveritë pjesëmarrëse duhet të përpiqen të bashkëkrijojnë e zbatojnë plane veprimi bashkë me publikun dhe shoqërinë civile përmes procesit të pjesëmarrjes. Siç përshkruhet në Seksionin III të këtij raporti, publikut dhe shoqërisë civile nuk u janë dhënë mundësitë për të përpiluar agjendën gjatë hartimit të planit katërt të veprimit për Shqipërinë. Ndërsa angazhimet e fundit rrjedhin nga strategjitë ekzistuese të qeverisë që janë hartuar në konsultim me shoqërinë civile, përfshirja e tyre në planin e veprimit të PQH-së nuk ishte rezultat i konsultimeve të dedikuara dhe shkalla me të cilën pasqyrohen përparësitë e shoqërisë civile në angazhimet e fundit është e paqartë.

Për planin e ardhshëm të veprimit, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes (DZHM) duhet të përfshijë shoqërinë civile që nga fillimi i procesit të bashkëkrijimit dhe të sigurojë që të kenë mundësi të mjaftueshme për të bërë propozime dhe komente në hartimin e angazhimeve. Gjithashtu, DZHM duhet të angazhohet në më shumë konsultime që i kushtohen veçanërisht agjendës së PQH-së edhe në rastet kur projekt-angazhimet janë marrë nga strategji që ekzistonin më parë. Qeveria gjithashtu duhet të publikojë ecurinë e zbatimit të planit të veprimit, duke përfshirë proces-verbalet, paraqitjet e kontributeve publike dhe rezultatet e angazhimit.

### **Ngritja e një forumi shumë-aktorësh të dedikuar me kritere të qarta e transparente për zgjedhjen e anëtarëve të tij**

Plani i katërt i veprimit për Shqipërinë është hartuar pa prezencën e një forumi shumë-aktorësh të dedikuar, për aktorët joqeveritarë të depozitonin propozimet dhe të jepnin opinionet për planin e veprimit. Mungesa e një forumi shumë-aktorësh (FSHA) ka kufizuar dukshëm mundësitë e angazhimit të shoqërisë civile në procesin e bashkëkrijimit dhe kjo çoi në një humbje të interesit të përgjithshëm nga ana e aktorëve joqeveritarë për procesin e PQH-së. Veç kësaj Standardet e Pjesëmarrjes dhe Bashkëkrijimit të PQH-së kërkojnë pjesëmarrjen e qeverive për të krijuar një FSHA për të mbikëqyrur procesin PQH-së në vend dhe aktualisht Shqipëria po vepron në kundërshtim me procesin PQH-së, duke mos e patur një forum të tillë<sup>1</sup>. Qeveria mund të marrë në konsideratë riangazhimin e anëtarëve joqeveritarë të forumit OpenAlb, që aktualisht ka pushuar aktivitetin, për të krijuar një strukturë të re të përbashkët për të hartuar dhe monitoruar planet e ardhshme të veprimit.

Për të siguruar një angazhim të hapur, DZHM ka gjithashtu nevojë të ndërtojë online, një platformë dhe të publikojë vazhdimisht informacion mbi forumin shumë-aktorësh, përfshirë rregullat e procedurave, anëtarësimin në forum dhe rastet e konsultimeve. Në fund, MPR kërkon që forumi i shumë-aktorëve të Shqipërisë të përvetësojë Standardet e PQH-së për Pjesëmarrje dhe Bashkëkrijim, duke përfshirë kërkesën që qeveria ose forumi të sigurojë përgjigje të arsyeshme për propozimet dhe opinionet e aktorëve.

Versioni për koment publik: Ju lutemi mos citoni

### **Konsiderimi i shtrirjes në më shumë organizata në nivel lokal**

Për ciklin e planit të ardhshëm të veprimit, MPR rekomandon që qeveria e Shqipërisë të marrë në konsideratë përfshirjen e organizatave me bazë komunitetin lokal. Përfshirja e më shumë palëve të interesuara në nivel lokal mund të ndihmojë në prezantimin e inovacioneve imponuese të qeverisë së hapur në fushat e aksesit në informacion, transparencës në prokurimin publik për shërbime dhe monitorimin e shpenzimeve të buxhetit lokal.

### **Sigurimi i zbatimit efikas të konsultimit publik mbi legjislacionin**

Ky rekomandim është bartur nga njëri prej rekomandimeve në vlerësimin e MPR-së për planin e veprimit të Shqipërisë për vitin 2016 - 2018. Ndërsa plani i veprimit të vitit 2016 - 2018 përfshinte angazhimin për ndërlidhjen e portalit për konsultimet e projekt-ligjit [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al) me portalin e-Albania, përdorimi i platformës publike mbetet i kufizuar. Për më tepër, megjithëse Angazhimi 3, në planin aktual të veprimit synon të hartojë rregullore dhe të trajtojë stafin e ministrive të linjës për kryerjen e konsultimeve publike dhe përdorimin e platformës, është e paqartë se si këto aktivitete do të çojnë në rritje të përdorimit nga publiku, apo në konsultime më të mira.

Në planin e ardhshëm të veprimit, qeveria mund t'i japë përparësi zbatimit të Ligjit mbi Njoftimin dhe Konsultimet Publike, i cili ngarkon me detyrime të shumta për publikimin e projekt-ligjeve dhe organizimin e konsultimeve. Qeveria mund të institucionalizojë praktikën për konsultim për hartimin e akteve nënligjore, të planifikojë kohën e duhur për konsultime, të vendosë rregulla të qarta për drejtimin e konsultimeve dhe të japë opinione mbi propozimet e dhëna nga qytetarët. Gjithashtu, që portali të jetë më i suksesshëm, MPR përsërit rekomandimet për promovim më të gjerë të portalit, mes qytetarëve duke përfshirë një fushatë të gjerë për rritjen e ndërgjegjësimit publik në përdorimin e medias tradicionale dhe sociale.

### **Konsiderimi i përfshirjes së angazhimeve në kontraktimin e hapur dhe prokurimin publik**

Nën Angazhimin 8 nga plani i mëparshëm i veprimit, Agjencia e Trajtimit të Konçesioneve krijoi një regjistër elektronik të disponueshëm për publikun, i cili përmban informacion për mbi 200 konçesione dhe partneritete publike-private (PPP)<sup>2</sup>. Megjithatë, siç vërehet në Raportin e Mbylljes së MPRë, të dhënat mbi PPP-të nuk janë të disponueshme në formatin e të dhënave të hapura dhe nuk ka informacion se sa paguan publiku në PPP, ose përmes cilës procedurë janë dhënë ato<sup>3</sup>.

Duke pasur parasysh nevojën e vazhdueshme për transparencë rreth PPP-ve dhe konçesioneve, MPR përsërit një nga rekomandimet e vlerësimit të planit të veprimit të vitit 2016 - 2018<sup>4</sup>. Domethënë, Shqipëria mund ta konsiderojë përfshirjen e angazhimeve që synojnë të harmonizojnë më mirë legjislacionin me rregullat e prokurimit publik të BE-së, duke përfshirë rekomandimet e BE-së, në një regjistër kontratash për të gjitha kontratat publike. Veç kësaj, qeveria mund të konsiderojë:

- Rritjen e cilësisë së të dhënave për çdo konçesion e PPP dhe të sigurojë publikimin e të dhënave në formatin e të dhënave të hapura në përputhje me Standardin e të Dhënave për Kontraktimin e Hapur SDHKH
- Lidhja e regjistrit me procesin e ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik;
- Forcimin e performancës së prokurimit elektronik dhe sistemit të monitorimit të detyrueshëm dhe të sigurojë raportim publik dhe monitorim të performancës;
- Vazhdimi i përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregulimi i regjistrit për adresimin e shqetësimeve të shoqërisë civile mbi përdorimin e informacionit të regjistrit dhe shtrirjen e informacionit të dhënë në portal. Këto ndryshime mund të përfshijnë aspekte që lidhen me formatin e informacionit (në të dhëna të hapura), dhe tipin e informacionit (p.sh. të ardhurat, taksat e mbledhura)

### **Konsiderimi i përmirësimit të zbatimit të Ligjit mbi të Drejtën e Informimit**

Ligji mbi të Drejtën e Informimit rregullon të drejtën e qytetarëve për akses në informacionin publik. Megjithatë, ka pika të dobëta në zbatimin e këtij ligji, siç është mungesa e shembujve specifikë dhe dobësia kërkon mekanizëm. Institucionet publike nuk i zbatojnë sistematikisht rekomandimet e organizmave mbikëqyrës siç është Avokati i Popullit. Nën angazhimin I nga plani i veprimit të vitit gjurmimin e kërkesave për informacion si dhe një regjister të kërkesave të informacionit lidhur me regjistrin e çdo institucioni shtetëror në nivel qendror apo lokal. Megjithatë, portali nuk jep informacion për përmbajtjen e këtyre kërkesave apo ndonjë lloj tjetër analize të përgjithshme<sup>5</sup>.

Ndërkohë që një numër në rritje i autoriteteve publike ka adoptuar programet e transparencës, institucionet publike mund të bëjnë më shumë përpjekje për të shpalosur në mënyrë aktive informacionin me interes publik. Për më tepër, mund të forcohet aksesin në informacionin mbi kontratat e prokurimit, kontrollet dhe pagat e zyrtarëve. Hapa të rëndësishëm në të ardhmen mund të përfshijnë gjithashtu përmirësimin e ndërgjegjësimit brenda organizmave publikë, se si të zbatojnë drejt ligjin, takimet me aktorët për të kontrolluar ndryshimet e ligjit dhe eliminimin e kategorive të informacionit të kufizuar.

### **Konsiderimi i përmirësimit të transparencës dhe integritetit të gjyqësorit**

Gjyqësori i Shqipërisë tradicionalisht ka patur nivele të larta korrupsioni, akuza për ndërhyrje politike dhe nivele të ulëta të besimit publik<sup>6</sup>. Në vitin 2018, Rrjeti Ballkanik i Raportimit Hetimor (BIRN) gjeti përgjithësisht nivele të ulëta të transparencës në shumicën nga 38 gjykatat shqiptare që ata monitoruan<sup>7</sup>. Që nga viti 2017, Shqipëria i është nënshtruar një procesi vetingu për gjykatësit dhe prokurorët si pjesë e procesit të pranimit në BE. Vetingu synon të shkarkojë anëtarët e gjyqësorit me pasuri të pajustificueshme, anëtarë që janë të korrumpuar, që kanë lidhje të dyshuara me krimin dhe anëtarë, të dhënat profesionale të të cilëve krijojnë shqetësime serioze<sup>8</sup>. Prosesi i vetingut ka çuar tashmë në shkarkimin e gati një të pestën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë edhe gjyqtarë të Gjykatës së Lartë<sup>9</sup>.

Për planin e ardhshëm të veprimit të Shqipërisë, MPR rekomandon të merren në konsideratë angazhime që përmirësojnë transparencën dhe integritetin e gjyqësorit në vend. Për shembull, angazhimet e ardhshme mund të fokusohen në përmirësimin e transparencës në emërimin e gjyqtarëve dhe caktimin e çështjeve. Angazhime të tjera në të ardhmen mund të synojnë publikimin e informacionit mbi sanksionet ndaj gjyqtarëve dhe paraqitje të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit të reformës në drejtësi.

**Tabela 5.1: Pesë Rekomandime të Rëndësishme**

1	Respektimi i Standardeve të pjesëmarrjes dhe bashkëkrijimit të PQH-së
2	Krijimi i një forumi të dedikuar shumë-aktorësh me kritere të qarta dhe transparente zgjedhjeje për anëtarët e tij.
3	Sigurimi i zbatimit efektiv të legjislacionit të konsultimit publik
4	Konsiderimi i përfshirjes së angazhimeve të cilat lidhen me kontraktimin e hapur dhe prokurimin publik
5	Konsiderimi i përmirësimit të transparencës dhe integritetit të gjyqësorit

## **5.2 Përgjigje për Rekomandimet e Mëparshme të Rëndësishme të MPR-së**

**Tabela 5.2: Rekomandimet e Rëndësishme nga Raporti i Mëparshëm i MPR-së**

	Rekomandimi	Iu Përgjigjën?	Të Integruar në Planin Aktual të Veprimit?
1	Sigurimi i një drejtimi të ri për PQH-në dhe transferimi i suksesshëm i njohurive institucionale që lidhen me të.	×	×
2	Respektimi i Standardeve të pjesëmarrjes dhe bashkëkrijimit të PQH-së.	×	×
3	Fokusimi në angazhime më ambicioze të PQH-së që lidhen me kontraktime të hapura në kuadrin e pranimit në BE.	×	×
4	Sigurimi i zbatimit efikas të legjislacionit të konsultimit publik.	×	×
5	Dhënia përparësi zbulimit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe aksesit të publikut në regjistrin e tokës.	×	✓

Nga pesë rekomandimet e planit të mëparshëm të veprimit (2016 - 2018), qeveria shqiptare përfshiu vetëm një në planin aktual. PQH në Shqipëri ka drejtues të rinj përfaqësuar nga zëvendëskryeministri dhe një person kontakti gjithashtu. Është ngritur një strukturë e re institucionale e PQH-së, me një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ndaj saj. Megjithatë, pati një mungesë të qartë të transferimit të njohurive institucionale për çështje që lidhen me PQH-në brenda qeverisë së ristrukturuar.

Plani i veprimit përfshin një angazhim për zbulimin e pasurive të zyrtarëve publikë. Megjithatë, aksesit i publikut në regjistrin e tokës nuk është përfshirë në këtë plan veprimi.

Shqipëria nuk i plotësoi Standardet e PQH-së për Pjesëmarrje dhe Bashkëkrijim gjatë hartimit të planit të veprimit. Shoqëria civile pati pak mundësi të japë mendime për propozimet e angazhimeve apo të paraqesë propozimet e tyre gjatë procesit të hartimit të planit. Gjithashtu qeveria nuk i dha shoqërisë civile përgjigje të arsyeshme se si u morën vendimet për të përfshirë angazhimet përfundimtare në planin e veprimit<sup>10</sup>.

Angazhimet e planit të veprimit janë nxjerrë nga dokumente strategjike ekzistuese<sup>11</sup>. Personi i kontaktit të PQH-së në qeverinë shqiptare informoi hulumtuesin e MPR-së se kriteret e përparësive të angazhimeve kishin lidhje me: a) rëndësinë strategjike; b) pajtueshmërinë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015 - 2020); c) strategjitë kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale dhe d) burimet financiare të disponueshme për zbatim.

<sup>1</sup> "Standartet e Pjesëmarrjes dhe Bashkëkrijimit të PQH-së", Partneriteti për Qeveri të Hapur, 2017, [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/07/OGP\\_Participation-Cocreation-Standards20170207.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/07/OGP_Participation-Cocreation-Standards20170207.pdf).

<sup>2</sup> "MPR, Raporti i Përfundimit për Shqipërinë, 2016-2018, MPR, Partneriteti për Qeveri të Hapur, shtator 2019, Fq. 28 [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/09/Albania\\_End-of-Term\\_Report\\_2016-2018\\_EN.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2019/09/Albania_End-of-Term_Report_2016-2018_EN.pdf).

<sup>3</sup> I njëjti burim.

<sup>4</sup> "Raporti i Progresit të MPR-së për Shqipërinë, 2016-2017", MPR, Partneriteti për Qeveri të Hapur, tetor 2018, Fq. 82, [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2018/10/Albania\\_Mid-Term\\_Report\\_2016-2018\\_EN.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2018/10/Albania_Mid-Term_Report_2016-2018_EN.pdf).

<sup>5</sup> I njëjti burim.

<sup>6</sup> Dr. Sinisa Milatović, "Sondazh mbi Qasjen në Drejtësi në Shqipëri", Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, [https://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/FINAL\\_DRAFT\\_SURVEY\\_EN.pdf](https://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/FINAL_DRAFT_SURVEY_EN.pdf)

<sup>7</sup> Shihni: "Raporti i Monitorimit për Transparencën e Gjykatave në Shqipëri", Rrjeti i Raportimit Hetimor Balkanik, 2018, <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2018/10/COURT-MONITORING-REPORT.pdf>.

<sup>8</sup> “Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2019”, Komisioni Europian, 29 maj 2019, Fq. 15 <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

<sup>9</sup> “Gjyqtari i gjykatës së lartë në Shqipëri u pushua për mosjustifikim të të ardhurave”, ABC News, 26 korrik 2019 <https://abcnews.go.com/International/wireStory/albania-high-court-judge-fired-income-inconsistencies-64585031>.

<sup>10</sup> E rsida Sefa OSFA Shqipëri, intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së më, 23 korrik 2019; Auron Pasha Drejtor Ekzekutiv i IDRA (Instituti për Alternativa Zhvillimi dhe Kërkimi), intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së më, 17 Shtator 2019; Blendi Dibra, Zëvendëskryetar i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së më, 23 Korrik 2019

<sup>11</sup> Evis Qaja, Person kontakti për PQH-në, intervistuar nga hulumtuesi i MRP-së, Korrik 2019.



## VI. Metodologjia dhe Burimet

Raportet e MPR-së janë përpiluar nga hulumtuesit për çdo vend apo subjekt pjesëmarrës në PQH. Gjithë raportet e MPR-së i nënshtrohen një procesi të kontrollit të cilësisë, për të siguruar që janë aplikuar standardet më të larta të hulumtimit dhe kujdesit të duhur.

Analizat mbi ecurinë e planeve të veprimit janë një kombinim i intervistave, të hulumtimeve, vëzhgimit dhe opinioneve nga aktorët joqeveritarë. Hulumtuesi i MPR-së nuk mundi të shfrytëzojë dokumentimin e procesit të hartimit të planit, apo gjurmuesin online, pasi ky dokumentim nuk ekziston. Në fillim të çdo cikli raportimi, stafi i MPR-së ndan me qeverinë një plan hulumtimi, për të hapur një periudhë shtatë ditore për komente apo opinione në lidhje me qasjen e propozuar të hulumtimit.

Secili nga hulumtuesit e MPR-së kryen intervista me palët e interesit për të siguruar një paraqitje sa më të saktë të aktiviteteve. Duke patur parasysh kufizimet buxhetore dhe kalendarike, MPR nuk mund të konsultoj të gjitha palët e interesuara ose të kryejë vizita në terren. Disa kontekste kërkojnë që i intervistuari të jetë anonim dhe MPR rishikon të drejtën për të hequr informacionin e identifikimit personal të këtyre pjesëmarrësve. Si rezultat i kufizimeve të domosdoshme të metodës, MPR mbështet fort komentet gjatë periudhës së rishikimit para publikimit për çdo raport.

Çdo raport i nënshtrohet një procesi të kontrollit të cilësisë që përfshin një rishikim të brendshëm nga stafi i MPR-së dhe Paneli i Ekspertëve Ndërkombëtarë (PEN) i MPR-së. Çdo raport gjithashtu i nënshtrohet një rishikimi të jashtëm ku qeveritë dhe shoqëria civile ftohen për të dhënë komente mbi përmbajtjen e projekt-raportit të MPR-së.

Ky proces rishikimi, duke përfshirë procedurën për përfshirjen e komenteve të marra, është paraqitur me më shumë detaje në Seksionin III të Manualit të Procedurave!

### Intervistat dhe kontributi i aktorëve

Për arsye se pak organizata të shoqërisë civile janë konsultuar direkt gjatë hartimit të planit të katërt të veprimit, hulumtuesi i MPR-së kontaktoi organizatat që ishin përfshirë në planet e mëparshme të veprimit për Shqipërisë, siç është Instituti për Alternativa Zhvillimi dhe Hulumtimi (IDRA), Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Instituti Shqiptar i Shkencës (ISHSH). Hulumtuesi i MPR-së intervistoi dy organizatat e para, por nuk ishte në gjendje të intervistonte një përfaqësues të ISHSH.

Në 5 korrik 2019, u mbajt një takim prezantues me përfaqësuesit shqiptarë të PQH-së në zyrën e Kryeministrit. Takimi u përqendrua në hapat që duhet të ndiqen në mënyrë që të realizohen intervista, përgatitje e një plani takimesh<sup>2</sup>, dhe përfundimi i procesit të mbledhjes së të dhënave. Të pranishmit ishin<sup>3</sup>:

- Evis Qaja Drejtor i Departmentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes (DZHM);
- Entela Erebara, Kabineti i Zëvendëskryeministrit;
- Alpina Qirjazi, Koordinator, DZHM dhe
- Sofia Kalashi, Koordinator, DZHM.

Personat e mëposhtëm janë të kontaktuarit gjatë intervistave personalisht apo me telefon:

- Evis Qaja - person kontakti për PQH-në, përfaqësues i DZHM-së në zyrën e Kryeministrit, 10 Korrik 2019, 17 Korrik 2019, 18 Korrik 2019;
- Alpina Qirjazi - Koorditore e PQH-së, përfaqësuese e DZHM-së në zyrën e Kryeministrit, 10 Korrik 2019 dhe 17 Korrik 2019 në zyrën e Kryeministrit;

Versioni për koment publik: Ju lutemi mos citoni

- Marseda Prifti, Drejtore e marrëdhënieve të E-Gov me institucionet, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), 17 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Nevila Repishti - Drejtore, AKSHI, 17 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Polana Lenja - Specialiste, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 17 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Erisa Rodhani - Kryetare Njësie, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 17 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Anisa Kume - Kryetare Njësie, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 17 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Nefrida Cocka - Specialiste, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 17 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Vjollca Simoni - Specialiste, INSTAT, 17 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Elona Servani - Drejtore Departamenti, INSTAT, 17 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Elton Alike - Specialist, INSTAT, 17 Korrik 2019 në zyrën e Kryeministrit;
- Erisa Proko - Shefe Kabineti, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktëve të Interesit (ILDKPKI), 18 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Elda Zenelaj - Drejtore në Njësinë Antikorrupsion, Ministria e Drejtësisë, 18 Korrik 2019, në zyrën e Kryeministrit;
- Ersida Stefa - Specialiste, OSFA, 23 Korrik 2019, në zyrën e OSFA-së;
- Mimoza Corbashi - Specialiste e Agjencisë për mbështetje të Shoqërisë Civile (AMSHC), 31 Korrik 2019, në zyrën e AMSHC-së;
- Emiliano Lule - përfaqësues i komunitetit të të verbërve, 22 Korrik 2019, në zyrën e AKSHI-t;
- Nekie Hoxha - përfaqësuese e grupit të të rinjve, 22 Korrik 2019, në zyrën e AKSHI-t;
- Intervistë telefonike me Blendi Dibra - zëvendës/kryetar i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, 23 Korrik 2019;
- Auron Pasha - Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Alternativa Zhvillimi dhe Hulumtime (IDRA), 17 Shtator 2019;
- Intervistë telefonike me Erdita Dojko - ish-specialiste në Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHHPAK), Shtator 2019;
- Intervistë telefonike me Anest Halili - specialist, Penta OJQ, Shtator 2019;
- Intervistë telefonike me përfaqësues të një OJQ-je lokale, që preferoi të mbetet anonim, Shtator 2019;
- Intervistë telefonike me Gerti Shella - Drejtor Ekzekutiv i INFOCIP, 4 Nëntor 2019.
- 

Hulumtuesi i MPR-së dërgoi një pyetësor tek personi i kontaktit tw PQH-sw në Sekretariatit Teknik i DZHM mbi procesin e hartimit të planit të veprimit. Hulumtuesi i MPR-së gjithashtu u dërgoi një pyetësor vijues personave të kontaktit në dy ministri dhe institucione të tjera përgjegjëse për hartimin e angazhimeve (psh. MFE, MD, INSTAT, AKSHI, ILDKPKI, DZHM).

Hulumtuesi i MPR-së gjithashtu zhvilloi një diskutim në grup me dy pjesëmarrës më 12 Korrik 2019, në zyrat e AKSHI-t në Tiranë. Pjesëmarrësit përfaqësonin projekte të ndryshme TIK në Shqipëri dhe grupe të personave me aftësi të kufizuara dhe të të rinjve. Të dy konfirmuan që ishin pjesë e procesit të konsultimit për Agjendën Digitale 2015 - 2020, por jo pjesë e një procesi konsultimi të dedikuar për PQH-në lidhur me Angazhimin 2.

Versioni për koment publik: Ju lutemi mos citoni

### **Rreth Mekanizmit të Pavarur të Raportimit**

Mekanizmi i Pavarur i Raportimit (MPR) është një mjet i rëndësishëm me anë të të cilit aktorët mund të gjerin informacion përparimin e PQH-së në vendet dhe subjektet pjesëmarrëse. Paneli i Ekspertëve Ndërkombëtarë (PEN) mbikëqyr kontrollin e cilësisë së çdo raporti. PEN është i përbërë nga ekspertë në metodat e transparencës, pjesëmarrjes, llogaridhënies dhe shkencës së kërkimit social.

Anëtarësia aktuale e Panelit të Ekspertëve Ndërkombëtarë është:

- César Cruz-Rubio
- Mary Francoli
- Brendan Halloran
- Jeff Lovitt
- Fredline M’Cormack-Hale
- Showers Mawowa
- Juanita Olaya
- Quentin Reed
- Rick Snell
- Jean-Patrick Villeneuve

Një staf i vogël me bazë në Washington, DC mbikëqyr raportet përmes procesit të MPR-së në koordinim të ngushtë me hulumtuesit. Pyetjet dhe komentet rreth këtij raporti mund t’i drejtohen stafit në adresën: [irm@opengovpartnership.org](mailto:irm@opengovpartnership.org).

---

<sup>1</sup> “Manuali i Procedurave të MPR, V.3”, MPR, <https://www.opengovpartnership.org/documents/irm-procedures-manual>

<sup>2</sup> Kalendar i takimeve është hartuar dhe dakordësuar nga të dy palët, hulumtuesi i MPR-së dhe personi i kontaktit për PQH-në

<sup>3</sup> Ka të dhëna (lista e fimosur e pjesëmarrësve) të të gjitha takimeve drejtuar nga hulumtuesi i MPR-së

## Shtojca I. Pasqyrë e performancës së Shqipërisë përmes hartimit të planit të veprimit

Të rëndësishme:

Jeshile: Plotëson standardet

E verdhë: Në vazhdim (janë ndërmarrë hapa për të plotësuar këtë standard, por nuk është arritur)

E kuqe: Nuk ka të dhëna për veprim

Forumi shumë-aktorësh	
<b>1a. Ngritja e Forumit: Ka një forum që mbikëqyr procesin PQH-së</b>	E kuqe
1b. Rregullore: Forumi mbledhet të patën një herë në tre muaj, personalisht ose në distance	E kuqe
1c. Zhvillimi i mandatit bashkëpunues: Anëtarët e forumit zhvillojnë bashkërisht strukturën e tij të anëtarësimit, anëtarësimit dhe qeverisjes.	E kuqe
1d. Mandati publik: Informacioni mbi fushën e veprimtarisë, anëtarësisë dhe strukturave qeverisëse është i disponueshëm në faqen në internet të PQH-së	E kuqe
<b>2a. Grupi shumë-aktorësh: Forumi përfshin përfaqësues tëqeverisë edhe jo-qeveritarë</b>	E kuqe
2b. Barazia: Forumi përfshin një ekuilibër të barabartë të përfaqësuesve qeveritar dhe joqeveritar	E kuqe
<b>2c. Zgjedhje transparente: Anëtarët joqeveritarë të forumit zgjidhen përmes një procesi të drejtë dhe transparent</b>	E kuqe
2d. Përfaqësimi i nivelit të lartë qeveritar: Forumi përfshin përfaqësues të nivelit të lartë me autoritet vendimmarrës nga qeveria	E kuqe
<b>3d. Hapja: Forumi pranon sugjerime dhe përfaqësime në procesin e planit të veprimit, nga çdo aktorë të shoqërisë civile apo aktorë të tjerë jashtë forumit</b>	E kuqe
3e. Pjesëmarrje në distancë: Ka mundësi për pjesëmarrje në distancë në të paktën disa nga takimet dhe ngjarjet	E kuqe
3f. Proces-Verbali: Forumi i PQH-së komunikon dhe raporton në mënyrë proaktive mbi vendimet, veprimtaritë dhe rezultatet me një gamë më të gjerë aktorësh qeveritarë dhe të shoqërisë civile	E kuqe

Versioni për koment publik: Ju lutemi mos citoni

Të rëndësishme:

Jeshile: Plotëson standardet

E verdhë: Në vazhdim (janë ndërmarrë hapa për të plotësuar këtë standard, por nuk është arritur)

E kuqe: Nuk ka të dhëna për veprim

<b>Hartimi i Planit të Veprimit</b>	
4a. Transparenca e procesit: Është një faqe kombëtare interneti e PQH-së (ose faqe e PQH-së e përfshirë në faqen e internetit të qeverisë) ku publikohet në mënyrë proaktive informacion mbi të gjitha drejtimet e procesit kombëtar të PQH-së.	E verdhë
4b. Dokumentacion paraprak: Forumi ndan informacion paraprak rreth aktorëve të PQH-së, për të siguruar që ata janë të informuar dhe të përgatitur të marrin pjesë në të gjitha fazat e procesit.	E kuqe
4c. Rritja e ndërgjegjësimit: Forumi zhvillon veprimtari në terren për rritjen e ndërgjegjësimit me aktorët me të cilët ka lidhje, për t'i informuar ata mbi procesin e PQH-së.	E kuqe
4d. Kanalet e komunikimit: Qeveria lehtëson komunikimin direkt me aktorët, që t'u përgjigjet pyetjeve për procesin e planit të veprimit, veçanërisht gjatë kohës së aktivitetit të madh të PQH-së	Jeshile
<b>4e. Përgjigje të arsyeshme: Forumi shume-aktorësh publikon arsyetimet e tij për vendimet dhe u përgjigjet kategorive të shumta të komenteve publike.</b>	E kuqe
<b>5a. Dokumentimi i procesit të hartimit të planit: Qeveria mbledh dhe publikon një dokument përmbledhës në faqen kombëtare të internetit të PQH-së, e cila paraqet një historik të dhënash dhe akses ndaj të gjithë dokumenteve që lidhen me procesin kombëtar të PQH-së, përfshirë (por jo i kufizuar) dokumentet e konsultimit, Planet Kombëtare të Veprimit, vetëvlerësimin e qeverisë, raportet e MPR-së dhe dokumente mbështetëse të zbatimit të angazhimeve (p.sh. linqet për bazën e të dhënave, të dhëna të takimeve, publikime)</b>	E verdhë

**Shënim i botuesit:** Nëse një vend "plotëson" gjashtë standardet shtypur në bold, MPR do ta njohë procesin e vendit si një Proces shënuar me Yje.